

RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	
EMËRTIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	Projektligji "Për Eficiencën energjetike"
MINISTRIA UDHËHEQËSE	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
FAZA E POLITIKËS/VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	Zhvillim/Konsultim/Finale
BURIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	I brendshëm/transpozim i BE-së/ndërkombëtar
DIREKTIVË/RREGULLORE E BE-së	Direktiva (BE) 2023/1791 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 13 Shtator 2023 "Për Eficiencën Energjetike".
PUBLIKIMET DHE STRATEGJITË E LIDHURA	Ky Ligj është në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Energjisë 2018-2030, Planin Kombëtar të Energjisë dhe Klimës 2021-2030, Programin Kombëtar për Aderimin në Bashkimin Evropian (PKABE) 2024-2030 dhe Planin Analitik të Akteve 2025.
DATA E KONSULTIMIT PUBLIK	Data/Asnjë konsultim publik
DATA E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	Data e vlerësimit të ndikimit
A E KA SHQYRTUAR KRYEMINISTRIA VLERËSIMIN E NDIKIMIT?	Po/Jo
NËSE PO, JEPNI DATËN E SHQYRTIMIT	Data e shqyrtimit
NUMRI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	Viti- ML – Nr. VN
TE DHËNA KONTAKTI (EMRI, E-MAIL, NUMRI I TELEFONIT TË PERSONIT TË KONTAKTIT)	

PJESA 1: PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE (maksimumi 2 faqe)

PËRKUFIZIMI I PROBLEMIT

Cili është problemi në shqyrtim dhe cilat janë shkaqet e tij? Jepni arsyet e nevojës së ndërhyrjes së qeverisë. (jo më shumë se 10 rreshta)

Problemi lidhet me eficiencën e ulët energjetike dhe konsum të lartë energjie (që con në kosto të larta) për njësi shërbimi apo për njësi prodhimi në të gjithë sektorët ekonomik në vend (residencial, shërbime publike shëndetsore dhe bashkiake, industri, transport i pasagjereve dhe të mallrave, bujqësi, peshkim, etj), emetime të larta të CO₂ dhe ndikime negative në mjedis dhe shëndetin publik të qytetareve.

Ligji Nr. 124/2015 për eficiencën e energjisë, i cili transponon Direktivën 2012/27/BE, është i tejkaluar dhe nuk përputhet me kërkesat e reja të Direktivës (BE) 2023/1791 e cila vendos standarde të reja në këtë fushë.

Shkaqet e Problemit:

Shqipëria ka një nivel efience energjie (që matet me intensitetin e energjisë) 2.25-2.5 here me të madh se intensitetet energjetike mesatare të cdo sektori ekonomik të vlerave respektive mesatare të vendeve të Bashkimit Evropian. Kjo vlerë e lartë e konsumit energjetik rezulton si pasoje e tre shkaqeve shumë të rëndësishme: i) produktiviteti i ekonomisë tone, edhe pse ka njohur rritje të konsiderueshme akoma është e ulët në krahasim me vende të Bashkimit Evropian dhe ii) niveli

teknologjik i sistemeve energjetike ne vendin tone eshte i vjeter (pra kemi sisteme me eficence te ulet) me gjithë ndryshimet e medha qe jane bere ne dekadën e fundit; iii) manaxhimi i energjise ne te gjithë sektoret akoma eshte ne nivelet fillestare meqenese akoma energjia konsiderohet si nje sherbim i lire. Gjithashtu, eshte e rendesishme te theksohet se megjithese MIE dhe AEE kane realizuar dis projekte pilote per eficencën e energjise, zbatimi i Ligjit aktual te EE ka qenë i pjesshëm dhe joefektiv për shkak të boshllëqeve në kuadrin institucional, mungesës së monitorimit, dhe sidomos te mjeteve të pamjaftueshme për mbështetje financiare. Kjo situatë ka ndikuar negativisht në përmbushjen e objektivave kombëtare për kursimin e energjisë, duke cënuar gjithashtu përmbushjen e detyrimeve të Shqipërisë si anëtare e Traktatit të Komunitetit të Energjisë.

Nevoja për ndërhyrjen e qeverisë është e domosdoshme për të siguruar që masa të nevojshme ligjore dhe investime që të mundësojnë rritjen e efikasitetit energjetike dhe uljen e konsumit dhe uljen e varësisë nga burime jo të rinovueshme, për të mbështetur zhvillimin e qëndrueshëm dhe për të arritur objektivat kombëtare për klimën.

OBJEKTIVAT

Cilat janë objektivat dhe rezultatet e synuara të propozimit? (jo më shumë se 7 rreshta)

Objektivat kryesore që synohen të arrihen nëpërmjet kësaj politike janë:

- Përcaktimi i një kuadri të përditësuar dhe të përputhshëm me direktivën e BE për të nxitur përdorimin e qëndrueshëm dhe efikas të energjisë në të gjithë sektorët;
- Përmirësimi i efikasitetit energjetike në të gjitha sektorët, reduktimi i konsumit të energjisë, reduktimi i emetimeve të gazeve serrë dhe rritja e përdorimit të burimeve të rinovueshme.
- Arritja e objektivave kombëtare të detyrueshme ne nivelin 9.4% reduktimi i Konsumit Final të Energjisë dhe 18.7% reduktimi i shkarkimeve të GES-ve deri në vitin 2030;
- Përcaktimi i sistemit kombëtar të mbledhjes dhe verifikimit të të dhënave energjetike;
- Promovimin e shërbimeve energjetike dhe përfshirjen e autoriteteve publike në kursimin e energjisë.

Rezultatet e synuara përfshijnë uljen e kostove energjetike, mbështetje për kalimin në burime të gjelbra, rritjen e investimeve dhe inovacionit në energji, si dhe përmbushjen e angazhimeve klimatike të BE-së. Këto masa do të kontribuojnë në një ekonomi më të qëndrueshme dhe efikente në energji.

OPSIONET E POLITIKAVE

Cilat janë opsionet kryesore të politikave? Duhet të bëni krahasimin e avantazheve/përfitimeve kryesore dhe të dizavantazheve/kostove të opsioneve të mundshme. (jo më shumë se 7 rreshta)

- "Opsioni 0 status quo" – Nuk do të ndërhyhet me ndryshim apo politikë të re dhe vijohet me kuadrin ligjor ekzistues. Nëpërmjet këtij opsioni nuk përmbushen kërkesat e reja të BE-së.
- "Opsioni 1" – Ndryshimi i ligjit aktual. Avantazhi i këtij opsioni është mundësia e ndërhyrjes në një kohë shumë më të shpejtë për zgjidhjen e problemeve dhe disavantazhi është mos garantimi i përputhshmëri të plotë dhe mbartja e rrezikut të paqartësive ligjore.
- "Opsioni 2" – Miratimi i një ligji të ri. Avantazhi i këtij opsioni është mundësia e ndërhyrjes në të gjithë kuadrin ligjor duke kryer edhe përafrimin e ligjit me direktivat e

BE që siguron transpozim të plotë dhe krijon bazën për një sistem funksional e të qëndrueshëm. Disavantazhi i këtij opsioni është koha e gjatë për të kryer një analizë më të gjerë.

- “Opsioni 3”- Ndryshimi jo me një akt rregullator. Avantazhi i ndryshimit është mundësia e ndërhyrjes së menjëhershme dhe disavantazhi i këtij opsioni është fakti se parashikimet e ligjeve **nuk mund të ndryshojnë me akte të tjera nënligjore.**

ANALIZA E NDIKIMEVE

Cilat janë ndikimet e opsionit të preferuar? Kjo duhet të përshkruajë ndikimet në mënyrë sasiore (monetare) dhe cilësore (narrative) mbi buxhetin dhe grupet e tjera të prekura. (jo më shumë se 10 rreshta)

Opsioni i zgjedhur ka ndikime mjedisore, ekonomike e sociale. Nëpërmjet hartimit, miratimit dhe zbatimit të një ligji të ri, sigurohet rregullimi i kësaj fushe në mënyrë shteruese duke mundësuar përshtatjen dhe koherencën me politikat ndërkombëtare mbi çështjet e efikasitetit të energjisë nëpërmjet përafrimit të Direktivës (BE) 2023/1791 me synim ofrimin dhe mundësinë për ndërhyrje të shpejtë dhe për të adresuar problemet urgjente të efikasitetit energjetike.

Qeveria nëpërmjet kësaj nisme synon ndërmarrjen e hapave konkret drejt politikës klimatike në përputhje me Marrëveshjen e Gjelbër dhe Marrëveshjen e Parisit sipas objektivave kombëtare të përcaktuar për efikasitetin e energjisë deri në vitin 2030 në PKEK. Efikasiteti i energjisë është një element thelbësor i Kornizës së Politikave të Klimës dhe Energjisë, të Bashkimit për vitin 2030 dhe është kyç për moderimin e kërkesës për energji.

Nëpërmjet vendosjes së standardeve të reja të efikasitetit energjetike, nisma e re ligjore synon reduktimin e kërkesës për energji në të gjithë sektorët ekonomik parashikon të sjellë reduktimin e konsumit final bruto të energjisë elektrike në vend për plotësimin e nevojave dhe si rrjedhim edhe në shpenzimet e blerjes së energjisë në tregun e liberalizuar. Përveç kësaj do të kontribuojë në reduktimin e gazeve me efekt serrë në atmosferë dhe sigurinë e furnizimit me energji.

Konsumi i energjisë elektrike nga përdoruesit final për secilin sektor referuar vitit 2023 arrin nivelin e 3860.81 ktoe dhe parashikohet të ulet në 2,250.6 ktoe në vitin 2030 nëpërmjet masave të efikasitetit. Për sa i përket emetimeve të GES-ve, rezultoni të jenë 557.2 [kt CO₂eq] në vitin 2023 dhe parashikohen të ulen në 430.0 [kt CO₂eq] deri në vitin 2050, duke përfaqësuar një rënie prej rreth 23%.

Ndikimet e Opsionit të Preferuar: Hartimi i një Ligji të Ri për Efikasitetin energjetike:

Ndikimet Financiare: Zbatimi i politikës së re, sjell përfitim për konsumatorët fundor të energjisë elektrike, institucionet publike dhe të gjithë sektorët e ekonomisë si rezultat i reduktimit të konsumit të energjisë elektrike dhe uljen e faturave për konsumatorët si rrjedhim i përmirësimit të efikasitetit të energjisë.

a. Kostot Fillestare të Implementimit:

- i. **Për Buxhetin:** Nga ana financiare, nuk parashikohet kosto shtesë direkte për buxhetin e shtetit për 3 vitet e para, pasi zbatimi do të mbështetet kryesisht në kuadrin ekzistues institucional dhe burime të mundshme mbështetëse nga donatorët dhe programet e BE-së.
- ii. **Institucionet publike:** Realizimi i procedurave të prokurimit publik në përputhje me nismën e re ligjore, “Masat për efikasitetin e energjisë që lidhen me blerjen nga autoritetet publike” do të kontribuojnë për reduktimin e konsumit final të energjisë dhe do të ndikojë në reduktimin e faturave të energjisë në terma afatgjatë; Gjithashtu arritja e objektivit kombëtar të përcaktuar për reduktimin e Konsumit Final të Energjisë do të kontribuojë në uljen e konsumit të energjisë elektrike prej tyre.

b. Operatorët Ekonomikë/Biznesi:

- **Kostot për Biznesin:** Pronarët do të kenë shpenzime për përmirësime të performancës energjetike si dhe te masave të tjera të efikasitetit për përmirësim teknologjik dhe inovacion.
- **Kursimet në Energji:** Duke përmirësuar efikasitetin e energjisë, operatorët mund të presin kursime të konsiderueshme në faturat e energjisë. Këto kursime mund të arrijnë deri në 30-50% të kostos së energjisë.
- **Inkurajimi i Inovacionit:** Kërkesat për teknologji të reja dhe më efikasitet do të stimulojnë inovacionin në sektorët e energjisë dhe ndërtimit.
- **Rritja e Konkurrencës:** Krijimi i një tregu më konkurrues për teknologjitë e reja alternative, me efikasitet do të ndikojë në reduktimin e çmimeve të produkteve që rrjedhimisht do të rezultojë në reduktimin e shpenzimeve për konsumatorët.

ç. Ndikimet mjedisore:

- **Reduktimi i Emetimeve të CO₂:** Zbatimi i standardeve të reja do të ndihmojë në reduktimin e emetimeve të karbonit nga të gjithë sektorët ekonomik që konsumojnë energji, duke kontribuar në përmbushjen e qëllimeve klimatike të vendit dhe BE-së.
- **Përmirësimi i Cilësisë së Ajrit:** Reduktimi i konsumit të energjisë dhe përdorimi i burimeve alternative të rinovueshme do të rezultojnë në një cilësi më të mirë të ajrit dhe një mjedis më të shëndetshëm për qytetarët.

d) Ndikimet Sociale:

Nga pikëpamja sociale, nisma e re do të kontribuojë në krijimin e vendeve të reja të punës dhe stimulimin e inovacionit në sektorin e energjisë dhe sektorët e tjerë ekonomik si dhe duke reduktuar kostot e përdorimit të energjisë elektrike dhe konsumin si dhe duke përmirësuar cilësinë e jetës, shëndetin dhe mirëqenien e qytetarëve.

Ndikimet cilësore përfshijnë rritjen e ndërgjegjësimit publik dhe nxitjen e investimeve private. Ky opsion do të ndihmojë në përmirësimin e efikasitetit energjetik në sektorë të ndryshëm (ndërtimi, transporti, industria) dhe do të kontribuojë në përmbushjen e angazhimeve mjedisore të Shqipërisë dhe BE-së. Ndërhyrjet e shpejta mund të sjellin përfitime afatshkurtra dhe afatgjata për mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm. Megjithatë, mund të ketë sfida në realizimin e të gjitha ndryshimeve të nevojshme për shkak të mungesës së kohës për analiza të plota.

ARSYETIMI I OPSIONIT TË PREFERUAR

Shpjegoni arsyet për zgjedhjen e opsionit të preferuar. Ju lutemi jepni nëse është e mundur koston dhe përfitimin me vlerë të përcaktuar monetare. (jo më shumë se 7 rreshta)

Opsioni i preferuar është **"Opsioni 2"** – Të hartohet një ligj i ri, i cili do të përditesojë dhe rregullojë kuadrin ligjor në fushën e efikasitetit energjetike, duke shfuqizuar Ligjin nr. 124/2015 "Për efikasitetin e energjisë" i ndryshuar. Opsioni 2 duket të jetë më i favorshmi për t'u përzgjedhur pasi nëpërmjet hartimit, miratimit dhe zbatimit të një ligji të ri sigurohet rregullimi i kësaj fushe në mënyrë shtruese.

Arsyet për zgjedhjen e opsionit 2 janë mundësia për ndërhyrje të shpejtë dhe zgjidhjen e problemeve aktuale me efikasitetin energjetike pa pritur një proces të gjatë miratimi ligjor. Ky opsion lejon përshtatje të shpejtë për të përmirësuar efikasitetin dhe përmbushur angazhimet ndërkombëtare, duke ruajtur fleksibilitetin në realizimin e ndryshimeve.

Opsioni i dytë, nëpërmjet hartimit të një ligji të ri, është më i përshtatshmi pasi mundëson transpozim të plotë të direktivës së BE-së (BE) 2023/1791, zgjidh mangësitë strukturore dhe krijon bazë për implementim efikas. Ai mundëson arritjen e objektivave kombëtare dhe evropiane në fushën e energjisë. Kosto financiare shtesë për buxhetin nuk parashikohet për periudhën 3-vjeçare pas miratimit të ligjit, ndërsa përfitimet afatgjata janë të rëndësishme për ekonominë dhe mjedisin. Gjithashtu, miratimi i një ligji të ri do të mundësojë përshtatjen dhe koherencën me politikat ndërkombëtare mbi efikasitetin energjetike dhe finalizohet transpozimi kombëtar dhe zbatimi i Direktivës (BE) Direktivës (BE) 2023/1791 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit. Duke miratuar dhe zbatuar një ligj të ri në këtë fushë, Republika e Shqipërisë përmbush gjithashtu detyrimet e saj në kuadër të Traktatit të Komunitetit të Energjisë, si dhe detyrimet që burojnë nga marrëveshje dhe traktate të tjera ndërkombëtare përkatëse. Miratimi i një ligji të ri rrit edhe qëndrueshmërinë në kohë të ligjit të miratuar, si dhe potencial për zbatim të saktë.

Përfitimi financiar: Pas implementimit të bazës së re ligjore, do të ketë kursim të energjisë për konsumatorët dhe bizneset nga ulja e humbjeve të energjisë dhe përmirësimi i efikasitetit energjetike. Përfitimet e mundshme për sektorin e energjisë dhe mjedisit mund të kontribuojnë në një rritje të qëndrueshme ekonomike afatgjatë.

Kostoja e përlloritur në total e opsionit të preferuar mbi buxhetin e shtetit gjatë periudhës 3-vjeçare menjëherë pas miratimit të ligjit (kostoja në total në Milion lek, çmimet aktuale, në terma nominalë):

	Viti 1	Viti 2	Viti 3
Kosto për buxhetin (institucionet qendrore dhe bashkiake) - një herë	1125		
Kosto për Investimet per EE/RES per buxhetin (institucionet qendrore dhe bashkiake) - në vazhdimësi	656	2,586	4,554

KONSULTIMI

Jepni një përmbledhje të çdo konsultimi të kryer (me kë dhe si jeni konsultuar? (jo më shumë se 5 rreshta)

Së pari, duhet mbajtur parasysh se kjo nismë është ndërmarrë nga Ministria e Infrastrukturës dhe e Energjisë nisur nga rekomandimet e ndryshme të organizmave ndërkombëtarë, si: Komisioni Europian, Parlamenti dhe Këshilli Europian dhe Sekretariatit i Komunitetit të Energjisë për vendosjen e një kuadri ligjor.

Së dyti, kjo nismë ligjore është konsultuar me ministritë e linjës dhe Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë dhe aktualisht janë reflektuar sugjerimet e paraqitura deri më tani.

Së treti, kjo nismë ligjore, si cdo akt tjetër është konsultuar me palët e tjera të interesuara në kuadrin e procedurës së konsultimit publik. Njoftimi është afishuar në RENJKP dhe në faqen zyrtare të MIE-s prej datës X, ku janë ftuar grupet e interesit të dërgojnë komentet/rekomandimet brenda 20 ditëve pune nga data e njoftimit për procesin e konsultimit publik.

ZBATIMI DHE MONITORIMI

Si do të organizohen zbatimi dhe monitorimi?(jo më shumë se 5 rreshta)

Institucionet përgjegjëse për zbatimin dhe monitorimin e opsionit të preferuar janë:

Zbatimi i ligjit do të koordinohet nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, në bashkëpunim me Agjencinë për Efiçencën e Energjisë do të monitorojë mënyrë periodike zbatimin e standardeve të efiçencës dhe institucionet e tjera të përfshira si Agjencia përgjegjëse për prokurimin publik dhe Institucionet e qeverisjes vendore.

Duke filluar nga data 28 shkurt 2022, çdo tre (3) vjet, bashkitë do të përgatisin dhe dorëzojnë në Agjencinë e Efiçencës së Energjisë (AEE) draft plane bashkiake të veprimit për efiçencën e energjisë (MECAP), të cilat do të përfshijnë politikat dhe masat e propozuara për efiçencën e energjisë, për të përmirësuar efiçencën e energjisë në të gjithë sektorët që veprojnë në nivel bashkiak.

ii) Përpara miratimit të Planit Lokal të Veprimit për Efiçencën e Energjisë nga Këshilli Bashkiak, AEE do të vlerësojë përputhshmërinë e tij me politikat kombëtare të efiçencës së energjisë, objektivat dhe planet përkatëse dhe do të japë opinionin e tij me rekomandime brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve nga data e paraqitjes së projektplanit. Miratimi i planeve lokale të veprimit për efiçencën e energjisë nga Këshilli Bashkiak duhet të bëhet përpara datës 30 prill të vitit përkatës dhe duhet të mbulojë tre (3) vitet në vijim.

iii) Plani, ndër të tjera, do të parashikojë ngritjen dhe funksionimin e sistemeve lokale të menaxhimit dhe monitorimit të energjisë, sipas rastit, përfshirë auditimet e energjisë për ndërtesat që konsumojnë shumë energji dhe për rinovimin e ndërtesave publike për të përmbushur standardet minimale të performancës energjetike të përcaktuara me Ligjin për Performancën e Energjisë në Ndërtesa. Masat e tjera të efiçencës energjetike të marra në objektet e kontrolluara nga bashkitë do të jenë pjesë e planit.

iv) Bashkitë që u kërkohet të zbatojnë një sistem lokal të menaxhimit të energjisë duhet të kenë të paktën 2 menaxherë të energjisë.

Bashkitë do të raportojnë në AEE nëpërmjet platformës së verifikimit dhe Monitorimit e cila do të jetë platforma kombëtare për vlerësimin e kursimeve të energjisë në rang kombëtar.

Monitorimi në rang kombëtar do të bëhet përmes sistemit kombëtar të raportimit të të dhënave të energjisë, auditimeve periodike dhe raporteve vjetore që do i dërgohen Komunitetit të Energjisë dhe BE-së.

PJESA 2: BAZA KRYESORE E ANALIZËS DHE E PROVAVE

1. HISTORIK

Jepni kontekstin e politikës.

Në Shqipëri, përpjekjet për të përmirësuar efikasitetin energjetik kanë nisur që në vitet e para të tranzicionit, pas viteve 1990, kur vendi kaloi nga një ekonomi e centralizuar në një ekonomi të tregut të lirë. Para viteve 90', sistemet energjetike ishin te vjetra, me konsum te larte energjetik, pa menaxhim te mirefillte energjetik dhe konsumi kontrollohej nga shteti përmes racionimit dhe mungesës së pajisjeve e sistemeve energjetike eficientë shume te perhapura ne vendet e Bashkimit European.

Gjatë viteve 1990–2000, kalimi në ekonomine e tregut u pasua me sfida të reja energjetike, ku kërkesa për energji u rrit ndjeshëm për shkak të liberalizimit dhe urbanizimit, mungesa e investimeve dhe infrastruktura e dobët çuan në humbje të mëdha të energjisë dhe ndërprerje të shpeshta dhe eficienta energjetike nuk ishte ende prioritet meqenese nje pjese e konsiderueshme e energjise nuk paguhej dhe ndergjegjesimi per rritjen e eficientes se energjise ishte ne nivele minimale. Gjithashtu, ne kete periudhe nuk kishte ende një kornizë ligjore për efikasitetin e energjisë. Ne kete periudhe u krijuan dy institucionet e para ish-Komiteti Kombëtar i Energjisë (me vone ish-Agjensia Kombëtare e Energjisë) dhe Qendra për Eficienten e Energjisë Shqiptari-BE.

Vitet 2000–2010 filluan hapat e parë drejt integritimit në dhe filluan reformat në sektorin e energjisë. Shqipëria u bë pjesë e **Komunitetit të Energjisë** në vitin 2006, duke marrë angazhime për të përputhur legjislacionin shqiptar me atë të BE-së. U krijuan institucionet e para rregullatore si **Enti Rregullator i Energjisë (ERE)** dhe u miratua Ligji i parë për efikasitetin energjetik me nr. 9396/2005, ndonëse zbatimi mbeti i kufizuar. Ne vitin 2003, Shqipëria miratoi një strategji kombëtare për zhvillimin energjetik ne teresi dhe efikasitetin energjetik ne vecanti, e cila synonte rritjen eficientë të përdorimit të energjisë në të gjithë sektorët, përfshirë sektoret: residential, shërbime publike shënderore dhe bashkiake, industri, transport te pasagjereve dhe te mallrave, bujqësor, peshkim, etj.

Në vitin 2015, Shqipëria miratoi Ligjin nr. 124/2015 "Për efikasitetin e energjisë", i cili vendosi bazat për ndërtimin e një politike moderne të efikasitetit në përputhje me **Direktivën 2012/27/BE**¹, nepermjet te cilit u synua ulja e

¹ **DIRECTIVE 2012/27/EU OF THE EUROPEAN PARLIAMENT AND OF THE COUNCIL of 25 October 2012 on energy efficiency, amending Directives 2009/125/EC and 2010/30/EU and repealing Directives 2004/8/EC and 2006/32/EC - DIREKTIVA 2012/27/BE E PARLAMENTIT DHE E KËSHILLIT EVROPIAN, datë 25 tetor 2012, mbi eficienten e energjisë, që amendon/perditeson Direktivat 2009/125/KE dhe 2010/30/BE dhe shfuqizon Direktivat 2004/8/KE dhe 2006/32/KE**

konsumit të energjisë dhe kalimi në një ekonomi të qëndrueshme dhe të gjelbër. Në vitin 2018, Shqipëria vijoi me përmirësimin e legjislacionit me miratimin e Strategjisë së Kombetare të Energjisë, e cila vendosi objektivat kombëtar për efikasitetin energjetik deri në vitin 2030. Gjithashtu në këtë periudhë u krijua **Agjencia për Efikasitetin e Energjisë (AEE)** si autoritet përgjegjës për zbatimin e masave dhe u miratuan rregulloret për auditimin energjetik të konsumatorëve të mëdhej të energjisë dhe për herë të parë u realizua certifikimi i audituesve energjetik të ndërtuesve. Në zbatim të ligjit nr. 124/2015, datë 10.11.2016 "Për efikasitetin e energjisë", janë në fuqi këto akte ligjore:

- VKM Nr.407, datë 19.06.2019 "Për miratimin e procedurës, të kategorive, kushteve, kërkesave të kualifikimit dhe të eksperiencës profesionale për personin, të cilit i lëshohet certifikata e audituesit energjetik"
- VKM Nr. 342, datë 22.5.2019 "Për miratimin e kategorive, të kushteve dhe kërkesave të kualifikimit për menaxherin e energjisë"
- VKM nr.852/2016 "Për krijimin dhe mënyrën e organizimit të funksionimit të Agjencisë për Efikasitetin e Energjisë"
- Udhëzim Nr. 9, datë 29.05.2023 "Për llojin dhe periodicitetin e informacionit që vihet në dispozicion nga Agjencia për Efikasitetin e Energjisë"
- Udhëzim Nr.2 datë 01.02.2023 "Për elementet, kërkesat dhe parimet e përgjithshme të analizës së kostos dhe përfitimit, për vlerësimin e potencialit të aplikimit të kogjenerimit me efikasitet të lartë, si dhe të ngrohjes së ftohjes efikente."
- Udhëzim Nr. 1, datë 27.01.2023 "Për miratimin e formularit dhe afateve për paraqitjen e të dhënave dhe informacionit për konsumin e energjisë";
- Urdhër Nr. 203/2022 "Për miratimin e formatit të planeve të veprimit të konsumatorëve të mëdhenj të energjisë dhe të raportit vjetor të progresit"
- Udhëzim Nr. 23, datë 17.10.2022 "Për modelin e kontratës për kontraktimin e performancës së energjisë".

Nisma e re për efikasitetin e energjisë, aktualisht në proces miratimi, e cila konsiston në vendosjen e objektivave të reja me ambicioze mbi kursimin e energjisë dhe përfshirje më të madhe institucionale, synon përputhje të plotë me direktivën e BE-se 2023/1791 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 13 Shtator 2023 "Për Efikasitetin Energjetik".

2. PROBLEMI NË SHQYRTIM

- 1. Përshkruani natyrën e problemit.*
- 2. Identifikoni shkaqet e problemit.*
- 3. Përshkruani shtrirjen e problemit.*
- 4. Identifikoni grupet e prekura nga ky problem - qeveria / biznesi / shoqëria civile / qytetarët.*
- 5. Vlerësoni nëse problemi mund të trajtohet ose jo përmes një ndryshimi të politikave.*

3. NATYRA E PROBLEMIT

Shqipëria ka një nivel efikasiteti energjetik (që matet me intensitetin e energjisë²) 2.25-2.5 herë më të madhe se intensitetet energjetike mesatare të çdo sektori ekonomik të vlerave respektive mesatare të vendeve të Bashkimit

² Intensiteti Energjetik është një tregues bazë për të shprehur në mënyrë sasimore nivelin e efikasitetit të energjisë. Intensiteti Global i çdo vendi matet me Sasine totale të burimeve primare energjetike të furnizuara gjatë një viti pjesuar me GDP përkatëse të atij viti. Në rastin konkret vlera e intensitetit të energjisë për Shqipërinë (për vitin 2025) është afërsisht 2.25 kWh/Euro vlerë e cila është 2.25-2.5 herë më të madhe se intensitetet energjetike mesatare të çdo sektori ekonomik të vlerave respektive mesatare të vendeve të Bashkimit Evropian (vlera mesatare 1.05 kWh/Euro brenda intervalit 1-1.1

European. Kjo vlerë e lartë e konsumit energjetik rezultoi pasojë e tre shkaqeve shumë të rëndësishme: i) produktiviteti i ekonomisë tona, edhe pse ka njohur rritje të konsiderueshme akoma është e ulët në krahasim me vendet e Bashkimit Europian dhe ii) niveli teknologjik i sistemeve energjetike në vendin tonë është i vjetër (pra kemi sisteme me efikasitet të ulët) me gjithë ndryshimet e mëdha që janë bërë në dekadën e fundit; iii) manaxhimi i energjisë në të gjithë sektorët akoma është në nivelet fillestare meqenëse ndërgjegjësimi në lidhje me efikasitetin e energjisë është në fazën fillestare dhe akoma energjia konsiderohet si një shërbim i lirë. Gjithashtu, është e rëndësishme të theksohet se megjithëse MIE dhe AEE kanë realizuar disa projekte pilote për efikasitetin e energjisë, zbatimi i Ligjit aktual të EE ka qenë i pjesshëm dhe joefektiv për shkak të boshllëqeve në kuadrin institucional, mungesës së monitorimit, dhe sidomos të mjeteve të pamjaftueshme për mbështetje financiare. Në tabelën 1 jepen në mënyrë të detajuar nivelet e efikasitetit të energjisë për të të gjithë sektorët ekonomik dhe shoqërorë duke e krahasuar atë me nivelet mesatare të të gjithë vendeve të BE-së.

Tabela 1: Nivelet e efikasitetit të energjisë për të të gjithë sektorët ekonomik dhe shoqërorë duke e krahasuar atë me nivelet mesatare të të gjithë vendeve të BE-së

Nr	Sektori	Njesia	Vlerat mesatare për Shqipërinë	Vlerat mesatare për të gjithë vendet e BE-së
1	Residencial	kWh/m ² *vit	104 ³ 200 – 220 ⁴	150-170
2	Shërbimet Publike Qendrore dhe Bashkiake	kWh/m ² *vit	80.425 220 – 250 ⁶	185-225
3	Shërbimet Private dhe Komerciale	kWh/Euro	0.40-0.44	0.32- 0.38
4	Industria	kWh/Euro	1.624	1.18
5	Transporti pasagjereve	kWh/100 pasagjer*km	58-65	35-40
6	Transporti mallrave	kWh/100 ton*km	48-55	28.5-32.0
7	Bujqësia	kWh/Euro	1.02	0.65
8	Total gjithë sektorët ekonomik dhe shoqëror	kWh/Euro	2.25	1.05

4. PROBLEMI KRYESOR NË SHQYRTIM LIDHET ME KUADRIN LIGJOR AKTUAL PËR EFIÇENCËN E ENERGJISË NË SHQIPËRI, I PËRCAKTUAR NGA LIGJI NR. 124/2015, I CILI ËSHTË I TEJKALUAR DHE NUK ËSHTË NË PËRPUTHJE ME ZHVILLIMET E FUNDIT NË

kWh/Euro). Me fjale të tjera – për të prodhuar 1 Euro ne harxhojmë 2.25 kWh (total komoditete energjetike), ndërsa vendet e Bashkimit Europian harxhojnë mesatarisht 1.05 kWh (total komoditete energjetike).

³ **Konsumi mesatar real për Ndertesat Residenciale** (bazuar në vlerat e bilancit energjetik dhe sipërfaqes totale të stokut të ndërtesave residenciale) është në vlerë të ulët duhet të kihet parasysh se nuk tregon një nivel të lartë efikasiteti të energjisë, vlera është e ulët në krahasim me vendet e BE pasi në shumicën e ndërtesave tona residenciale nuk plotësohen kushtet e komfortit (për ngrohjen dhe ftohjen tërësore të mjediseve, uji i ngrohtë garantohet në vlerë minimale dhe pajisjet elektrike janë në mesatare të penetrimit të tyre).

⁴ **Konsumi mesatar i llogaritur për Ndertesat Residenciale** (bazuar në vlerat e Planit Kombëtar Afatgjatë të Rinovimit të Stokut të Ndertesave) me plotësim të kushteve të komfortit (për ngrohjen dhe ftohjen tërësore të mjediseve, uji i ngrohtë garantohet sipas normave të lartësive personale të përdoruesve), gatimi sigurohet dhe pajisjet elektrike janë në vlerë normale të penetrimit të tyre.

⁵ **Konsumi mesatar real për Ndertesat Publike Qendrore dhe Bashkiake** (bazuar në vlerat e bilancit energjetik dhe sipërfaqes totale të stokut të ndërtesave Publike) është në vlerë të ulët duhet të kihet parasysh se nuk tregon një nivel të lartë efikasiteti të energjisë, vlera është e ulët në krahasim me vendet e BE pasi në shumicën e ndërtesave tona Publike nuk plotësohen kushtet e komfortit (për ngrohjen dhe ftohjen tërësore të mjediseve, uji i ngrohtë garantohet në vlerë minimale, gatimi (përveç cerdheve, kopshteve dhe shtëpave) nuk sigurohet dhe pajisjet elektrike janë në vlerë minimale të penetrimit të tyre).

⁶ **Konsumi mesatar i llogaritur për Ndertesat Publike Qendrore dhe Bashkiake** (bazuar në vlerat e Planit Kombëtar Afatgjatë të Rinovimit të Stokut të Ndertesave) me plotësim të kushteve të komfortit (për ngrohjen dhe ftohjen tërësore të mjediseve, uji i ngrohtë garantohet sipas normave të lartësive personale të përdoruesve), gatimi sigurohet në të gjithë ndërtesat që kërkohet dhe pajisjet elektrike janë në vlerë normale të penetrimit të tyre.

NIVEL EVROPIAN, KONKRETISHT ME DIREKTIVËN (BE) 2023/1791. LIGJI EKZISTUES NUK GARANTON MË NJË MJET TË BESUESHËM PËR ARRITJEN E OBJEKTIVAVE KOMBËTARE DHE NDËRKOMBËTARE PËR REDUKTIMIN E KONSUMIT TË ENERGJISË DHE PËRMBUSHJEN E ANGAZHIMEVE NDAJ KOMUNITETIT TË ENERGJISË DHE BE-SË.

Shkaqet e problemit:

- Zbatimi ishte i fragmentuar duke krijuar boshllëqe.
- Mungesë përputhjeje me objektivat e klimës të vitit 2050, pasi direktiva nuk parashikonte masa të mjaftueshme për të mbështetur tranzicionin drejt neutralitetit klimatik.
- Ligji Nr. 124/2015 mbulonte mjaftueshëm varfërinë energjetike dhe sektorët vulnerabël.
- Raportimi dhe monitorimi paraqitej me mungesë të të dhënave të krahasueshme e të harmonizuara.

5. POLITIKAT EKZISTUESE JANË TË PAMJAFTUESHME PËR TË ADRESUAR KËTO PROBLEME DHE NUK OFROJNË STIMUJ TË MJAFTUESHËM PËR INOVACIONIN DHE INVESTIMET NË TEKNOLOGJITË E AVANCUARA NË FUSHËN E ENERGJISË

Shkaqet e problemit

Shkaqet kryesore të problemit, të cilat çuan në nevojën për rishikim dhe zëvendësim të politikës aktuale në fuqi, janë si me poshte:

1. Evoluimi i kuadrit ligjor të BE-së për efikasitetin e energjisë

Angazhimi i Shqipërisë si vend kandidat për hyrjen në BE, në fazën e negociatave për transpozimin e legjislativës evropiane shërben si motiv kryesor për rishikimin e përmirësimit të ligjeve në fushën e efikasitetit, si në kontekstin politik, ekonomik dhe teknik. BE ka përditësuar kuadrin e saj rregullator me Direktivën (BE) 2023/1791, duke vendosur objektiva më ambiciozë dhe mekanizma më të detajuar për përmirësimin e efikasitetit të energjisë deri në vitin 2030 dhe më tej. Ligji Nr. 124/2015 ishte i harmonizuar me një direktivë tashmë të shfuqizuar dhe nuk përmbante instrumentet e reja të kërkuara nga direktiva e re. Gjithashtu, vlen të theksohet se objektivat e vendosura në NECP bazuar në direktivën e energjisë dhe klimës për vitin 2030 e më tej nuk mund të arrihen duke qenë se ato synime që mbështeteshin mbi instrumentat e përcaktuar në Ligjin Nr. 124/2015.

Rishikimi i Ligjit Nr. 124/2015 (i rishikuar pjesërisht në vitet 2019 dhe 2021) u bë i domosdoshëm për të adresuar boshllëqet strukturore, institucionale dhe teknike të politikës ekzistuese dhe për të përputhur legjislativën kombëtare me standardet dhe objektivat e rinj të BE-së, si një hap i rëndësishëm drejt tranzicionit të gjelbër dhe përmirësimit të sigurisë energjetike të vendit.

2. Mungesa e rezultateve të pritshme nga zbatimi i Ligjit Nr. 124/2015

Pas hyrjes në fuqi të ligjit 124/2015, Shqipëria nuk kishte arritur objektivat kombëtare (për të arritur një nivel kursimi afërsisht prej 5% dhe 8.4% respektivisht vitet 2020 dhe 2030) të kursimit të energjisë, veçanërisht në sektorët publik, ndërtesa dhe transport edhe për shkak të zbatimit të pjesshëm të këtij legjislativi. Bazuar në raportet e pjesëshme të monitorimit të nivelit të kursimit të energjisë i arritur në nivelin vendi në vitin 2025 ishte afërsisht 1-1.15% më e vogël se e krahasojme me objektivin prej 7% që duhet të arrihej në vitin 2025.

Disa nga arsyt kryesore të mos arritjes së objektivave të vendosura në ligjin e EE të sipërpermenduar lidhen me:

Draft-Raporti i Vlerësimit të Ndikimit

- **Ndergjegjesim ne nivel te ulet ne lidhje me eficecencen e energjise** nga te gjitha kategorive te konsumatoreve ne te gjithë sektoret ekonomik (sektoret: residencial, sherbime publike shenderore dhe bashkiake, industri, transport te pasagjereve dhe te mallrave, bujqësor, peshkim, etj);
- **Nivel i ulet i njohurive ne lidhje me kostot energjetike** ne te gjithë sektoret ekonomik (sektoret: residencial, sherbime publike shenderore dhe bashkiake, industri, transport te pasagjereve dhe te mallrave, bujqësor, peshkim, etj). Kjo ka bere qe efienca e energjetise te mos shikohet gjeresisht si zgjidhja me adeguate dhe me leverdi financiare per reduktimin e kostove ne cdo sector.
- **mbivendosje kompetencash nga ana e institucioneve** ne nivel qendror dhe nivel bashkiak per te gjitha sherbimet ne ndertesat Publike, ujesjellesa, ujra te zeza, mbetje urbane, transport publik dhe ndricim publik,
- **Vonesa ne zbatimin e legjislacionit nga shumica e institucioneve ne nivel qendror dhe nivel bashkiak.** Ne studimin e realizuar nga Banka Boterore, parametrat e efienca se energjise u konsideruan vetem ne nivelin 15-20% ne te gjithë tenderat per te gjitha sherbimet ne ndertesat Publike, ujesjellesa, ujra te zeza, mbetje urbane, transport publik dhe ndricim publik,
- **Mungesa e nje “zyre oneline”** per te shperndare njohuri teknike dhe financiare ne lidhje me mundesite me te mira dhe avantazhet te masave te kursimit te energjise ne te gjithë sektoret ekonomik (sektoret: residencial, sherbime publike shenderore dhe bashkiake, industri, transport te pasagjereve dhe te mallrave, bujqësor, peshkim, etj);
- **Mungesa e financimit per EE nga ana e Bankave te nivelit te dyte** per shkak te mungeses te njohurive teknikeper vleresimin e projekteve ne lidhje me mundesite me te mira dhe avantazhet te masave te kursimit te energjise ne te gjithë sektoret ekonomik (sektoret: residencial, sherbime publike shenderore dhe bashkiake, industri, transport te pasagjereve dhe te mallrave, bujqësor, peshkim, etj)
- **Efienca e Energjise sic u theksua me siper eshte ndersektoriale dhe mungesa e koordinimit nderinstitucional** eshte nje tjetër faktor qe ka influencuar ne mos arritjen e objektivave sidomos ne sektoret publik qendror dhe bashkiak.
- **Mungesa e nje Fondi Kombetar te Efieneses se Energjise** – fond i cili ekziston ne te gjithë vendet e Ballkanit Perndimor dhe te gjitha vendet e Bashkimit European.

3. Korniza institucionale joefektive dhe mospërputhja me praktikat më të mira të BE-së

- **mbivendosje kompetencash nga ana e institucioneve** ne nivel qendror dhe nivel bashkiak per te gjitha sherbimet ne ndertesat Publike, ujesjellesa, ujra te zeza, mbetje urbane, transport publik dhe ndricim publik,
- **Vonesa ne zbatimin e legjislacionit nga shumica e institucioneve ne nivel qendror dhe nivel bashkiak.** Ne studimin e realizuar nga Banka Boterore, parametrat e efienca se energjise u konsideruan vetem ne nivelin 15-20% ne te gjithë tenderat per te gjitha sherbimet ne ndertesat Publike, ujesjellesa, ujra te zeza, mbetje urbane, transport publik dhe ndricim publik,
- **Mungesa e nje “zyre online”** per te shperndare njohuri teknike dhe financiare ne lidhje me mundesite me te mira dhe avantazhet te masave te kursimit te energjise ne te gjithë sektoret ekonomik (sektoret: residencial, sherbime publike shenderore dhe bashkiake, industri, transport te pasagjereve dhe te mallrave, bujqësor, peshkim, etj);

Vlen te theksohet se ligji ekzistues te EE nuk përfshinte në mënyrë të qartë dhe te detyrueshme ndarjen e përgjegjësi ndërmjet autoriteteve qendrore dhe atyre lokale, ashtu siç kërkohet në direktivën e re sidomos persa lidhet me investimet ne EE ne te gjithë sektoret ekonomik-shoqëror.

Ligji ekzistues i EE nuk ka bere te mundur te krijohet nje sistem te dhenash energjetike ne pergjigthesi dhe te eficences se energjise ne vecanti per te bere te mundur mbledhjen, analizimin dhe raportimin e të dhënave të konsumit të energjisë ne cdo sektor ekonomik dhe me pas nepermjet "zyres online" (qe gjithashtu ka munguar) te behet i mundur ndergjegjesimi per rendesine e madhe ne reduktimin e koston energjetike se jetes (ne sektorin residencial), koston energjetike te sherbimit (ne sektoret e sherbimeve publike dhe private) dhe koston energjetike te prodhimit.

+

Shtrirja e problemit: Problemi ka një ndikim shumëdimensional që është i përhapur në të gjithë territorin e vendit. Ai përfshin sektorin publik dhe privat, duke ndikuar në konsum të lartë të energjisë, pajisjeve dhe infrastrukturës, si dhe në konsumatorët fundorë. Mungesa e një kuadri të harmonizuar me BE e rrezikon procesin e integritimit dhe pamundëson përfitimin e fondeve të huaja për sektorin e energjisë.

Si konkluzion, duhet te theksojme se ligji aktual nuk mundeson funksionim efikas te mekanizmave institucionale, dhe si rezultat, nuk permbush standardet e BE-se. Gjithashtu analiza e shkurter dhene me siper, tregoi se korniza institucionale aktuale eshte joefektive, pasi nuk percakton ne menyre te qarte ndarjen e pergjegjesive ndermjet autoriteteve qendrore dhe lokale, gje qe shkakton mbivendosje kompetencash, mungese koordinimi dhe vonesa ne zbatimin e legjislacionit. Kjo situatë ka sjelle mosperputhje me praktikën me te mira te BE-se dhe kerkon rishikim ligjor per te qartësuar rolet institucionale.

Grupet e Prekura nga Ky Problem

Analiza sasiore e nivelit te eficences se energjise, te dhene ne tabelen 1, tregon ne menyre te detajuar se nivelet e ineficences se energjise ne vendit tone ne cdo sektor jane nga 50% deri ne 150% me te larta se nivelet mesatare te te gjithë vendeve te BE-se. Nga ky krahasim i nivelit te ulet te eficences (ose nivelit te larte te ineficences) aktualisht janë të prekur te gjithë kategorie e konsumatoreve te perfshira ne te gjithë sektoret ekonomik te siper-permendur dhe me konkretisht:

- **Institucionet e qeverisjes qendrore** përballen me sfida në përmbushjen e qëllimeve të kursimit të energjisë dhe klimës, si me çështjet e sigurisë së furnizimit me energji elektrike dhe uljen e konsumit të energjisë si dhe me presionin për të ulur emetimet konform angazhimeve ndërkombëtare.
- **Organet e vetë-qeverisjes vendore** (Bashkitë dhe njësitë administrative), te cilat duhet te kontribuojne ne përmbushjen objektivave për dekarbonizim dhe eficencë energjetike.
- **Bizneset** (Operatoret ekonomike dhe ndermarrjet e vogla dhe te mesme) **per shkak te eficences se ulet energjetike**, përballen me kosto ta larta energjetike gje e cila rrit koston e sherbimit dhe produktit dhe vershtireson konkurrueshmerine në tregun vendor, tregun rajonal dhe me gjere tregun e BE-se. Shpenzimet e larta të energjisë ndikojnë në konkurrueshmërinë dhe fitimet dhe shpesh here edhe ne mbylljen e bizneseve ne se nuk investojne ne rritjen eficences se energjise.
- **Qytetarët** ekspozohen ndaj koston të larta të energjisë dhe kushteve të dobëta të jetesës duke ulur kfortin energjetik, dhe kjo veçanërisht behet me e theksusr ne grupet vulnerabël të cilët

përrjetojnë rritjen e kostove të energjisë dhe ndikimet negative në shëndet si dhe mungesë të theksuar komforti.

Problemi mund të trajtohet me ndryshimin e politikave.

Problemi mund të trajtohet përmes ndërhyrjeje të zbatimit të politikave energjetike lidhur me eficienten e energjise me ritme shume me te shpejta dhe duke perfshire te gjithë sektoret ekonomiko-shoqeror sic kerkohet edhe ne direktiven e re te EE.. Zëvendësimi i ligjit ekzistues me një projektligj të ri, në përputhje të plotë me Direktiven (BE) 2023/1791, do të adresojë boshllëqet aktuale, do të forcojë bazën ligjore për kursimin e energjisë dhe do të sigurojë që Shqipëria të ecë paralelisht me standardet e BE-së në tranzicionin e gjelbër.

Ndryshimet e politikave mund të përfshijnë:

- **Vendosjen e objektivave të reja të detyrueshme për çdo konsumator të madh**, në secilin sektor, për të investuar në masa të EE të cilat janë edhe me leverdi financiare;
- **Realizimi i fushatave shume me te forta dhe te vazhdueshme ne lidhje me zbatimin e masave te eficences se energjise** (si dhe teknologjive perkatese) nga te gjitha kategorite e konsumatoreve dhe me perfutime direkt financiare per secilin;
- **Realizimi ne praktike i rolit shembullor te institucioneve publike qendrore dhe vendore** në drejtim të investimit dhe manaxhimit shume me te mire te masave te eficences se energjise;
- **Krijimi i Fondit të Eficences se Energjise** për nxitjen e EE në të gjithë sektoret ekonomiko-shoqeror;
- **Krijimi i kushteve mbeshtetese per Bankat e nivelit te dyte per te investuar ne skemat e EE** për të gjithë bizneset dhe pronarët e shtepive;
- **Mbeshtja financiare per krijimin e kompanive ESCO (Kompanive te Sherbimit Energjetik) si dhe krijimin e kushteve mbeshtetese per Kompanite ESCO** për të investuar në skemat e EE për të gjithë bizneset dhe shërbimet publike qendrore dhe bashkiake;
- **Vendosjen e Standardeve të Reja**: Kjo do të siguronte që të gjitha ndërtesat e reja;
- **Ofrimi i Subvencioneve dhe Incentivave nepermjet Fondit të Eficences se Energjise**: Të ndihmojnë pronarët e bizneseve, entet publike qendrore dhe bashkiake të mbulojnë kostot fillestare të investimeve në energji të rinovueshme dhe eficienten e energjisë.

6. ARSYEJA E NDËRHJRJES

6. Shpjegoni pse qeveria e sheh të nevojshme të ndërhyjë.

7. Shpjegoni se çfarë shpreson të trajtojë qeveria nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje.

8. Shpjegoni se si i mbështet kjo ndërhyrje objektivat e nivelit të lartë të qeverisë.

9. Rendisni punën ekzistuese që është realizuar tashmë.

Qeveria e sheh të nevojshme të ndërhyjë në përmirësimin e eficientes se energjise sepse sic u analizua me siper nivelin e larte te inefficences ka impakt te drejtperdrejte ne te gjithë sektoret ekonomik dhe shoqeror por mbi te gjitha drejtperdrejt ne te gjithë institucionet qendrore dhe bashkiake. Ineficenca e larte energjetike sjell kosto te larte energjetike për të gjitha shërbimet dhe për t'i mbuluar këto nevoja të larta do të kërkojë buxhet gjithmone e me i larte.

Për të gjithë sektoret e tjere jo-buxhetor Qeveria e sheh të nevojshme të ndërhyjë në përmirësimin e eficientes se energjise për: i) sektorin familjar duke sjelle shtrejtimit të jeteses, ulje të komfortit dhe nëse familjarët nuk ndërhyjnë duke zbatuar masa të EE atëherë pjesa e familjeve në varferi energjetike do të shtohet dhe kjo do të detyrojë Qeverinë të shtojë fondet për asistencë sociale; ii) të gjithë bizneset do të rrisin kostot e shërbimeve dhe produkteve

te tyre dhe ne se pronaret e bizneseve nuk nderhyjne me masa te EE kosto rritet tej mase, fitimi bruto zvogelohet, taksat e tatim-fitimit zvogelohet dhe kjo ka ndikim te drejtperdrejt ne te ardhurat nga taksat duke e vendosur Qeverine ne veshtiresi per fonde dhe do ta detyroje te marre hua shtese. Ne se inficenca e bizneseve behet gjithmone e me larte kjo mund te coje ne humbje medha financiare dhe kjo ne disa raste con ne mbylljen e bizneseve. Mbyllja e bizneseve ka ndikim te dyfishte tashme tek Qeveria ne uljes te te ardhurave nga taksat dhe fondi per asistence sociale do te duhet te shtohet per te mbuluar tashme shtesen e fuqise punetore qe doli nga pune.

Qeveria nËpËrmjet ndËrhyrjes te rritjes se EE ne sektoret: residencial, sherbime publike shendetesore dhe bashkiake, industri, transport te pasagjereve dhe te mallrave, bujqËesor, peshkim, etj synon arritjen e shume objektivave: i) te gjithë kategorite e konsumatoreve te permiresojne eficencen e energjine, te reduktojne kostot e sherbimeve energjetike; ii) te rrisin konkurreshmerine dhe iii) te rrisin nivelin komfortit. Te gjitha keto do ta bejne ekonomine tone shume me konkurruese dhe te aderoje ne menyre te qendrueshme ne tregun e Bashkimit Europian. Rritja e EE ne te gjithë sektoret do ta ndihmoje Qeverine qe te ule shpenzimet per te mbuluar kostot energjetike dhe kursimet buxhetore t'i perdore ne sektore tjere shume me prioritare si edukimi, shendetesia dhe rritjen e aftesive profesionale te te gjithë stafeve dhe te fuqise punetore ne drejtim te manaxhimit me te mire energjetik.

Pra sic u theksua me siper eficenca e energjise eshte nje nga prioritetet kryesore tË qeverisË. Nje arsye tjeter po aq e rendesishme dhe kryesore nga ana e Qeverise pËr ndËrhyrje bazohet nË angazhimin **ndËrkombËtar pËr klimËn dhe energjinË: Ligji Nr. 75/2016 "PËr ratifikimin e MarrËveshjes sË Parisit"**, i miratuar nË datËn **14 korrik 2016**. MarrËveshja e Parisit pËr Ndryshimet Klimatike nuk ËshtË miratuar vetËm me nË vendim qeverie, por ËshtË ratifikuar me ligj nga Kuvendi i ShqipËrisË, proces qË i jep asaj fuqi tË plotË ligjore nË vend. **Qeveria** e nËnshkroi MarrËveshjen e Parisit mË **22 prill 2016** nË Nju Jork. Pas miratimit nË Kuvend (Ligji 75/2016), dokumentet e ratifikimit u depozituan pranË OKB-sË mË **21 shtator 2016**. PËr ShqipËrinË, marrËveshja hyri zyrtarisht nË fuqi mË **4 nËntor 2016**, e nËjta datË kur marrËveshja hyri nË fuqi globalisht. PËrmes kËtij ratifikimi, ShqipËria mori detyrimin ndËrkombËtar pËr: i) Reduktimin e emetimeve tË gazeve me efekt serË (dhe ne themel reduktimi I gazeve sere arrihet nËpËrmjet rritjes se eficences se energjise dhe shfrytezimit bazuar nË Kontributin e PËrcaktuar KombËtar - NDC); ii) Hartimin e strategjive pËr pËrshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike; dhe iii) Raportimin periodik mbi progresin e arritur. Gjithashtu, nË zbatim tË kËtij ligji, Qeveria ka miratuar mË pas akte nËnligjore tË tjera, si **Vendimi i KËshillit tË Ministrave (VKM) Nr. 466, datË 3.7.2019**, i cili miraton "Dokumentin Strategjik dhe Planet KombËtare pËr Zbutjen e Gazeve me Efekt SerrË dhe pËr PËrshtatjen ndaj Ndryshimeve Klimatike". E theksojme perseri se ne themel te kËtij dokumenti qendron rritja e eficences se energjise ne te gjithë sektoret: residencial, sherbime publike shenderore dhe bashkiake, industri, transport te pasagjereve dhe te mallrave, bujqËesor, peshkim, etj.

Nisma e re per rritjen e EE ne cdo sektor, sic u prezantua me siper ËshtË e lidhur ngushtË me angazhimet ndËrkombËtare tË shtetit nË kuadËr tË marrËveshjeve dhe protokolleve tË ndryshme pËr klimËn dhe energjinË, siç janË MarrËveshja e Parisit pËr ndryshimet klimatike dhe Objektivat pËr Zhvillim tË QËndrueshËm (SDG). Sektore te ndyshem ekonomik janË nË burim i rËndËsishËm i konsumit tË energjisË dhe emetimit tË gazeve serË, kËshtu qË pËrmirËsimi i eficencËs sË energjisË nË to ËshtË nËjË prioritet global dhe kombËtar. Qeveria e konsideron tË nevojshme ndËrhyrjen nË kuadrin ligjor pËr eficencËn e energjisË pËr tË adresuar mungesat thelbËsore tË Ligjit Nr. 124/2015 dhe pËr tË siguruar pËrputhshmËri me DirektivËn (BE) 2023/1791. NdËrhyrja ËshtË domosdoshmËri ligjore, si pjesË e detyrimeve tË vendit nË kuadËr tË Traktatit tË Komunitetit tË EnergjisË dhe procesit tË anËtarËsimit nË Bashkimin Evropian. Pa kËtË pËrditËsim ligjor, ShqipËria rrezikon masa pËr moszbatim dhe humbjen e mbËshtetjes financiare ndËrkombËtare.

7. QEVERIA PLANIFIKON TË TRAJTOJË DISA PROBLEME KYÇË:

- REDUKTIMI I HUMBJEVE TË ENERGJISË DHE PËRMIRËSIMI I EFIÇENCËS NË SEKTORËT E NDËRTIMIT, INDUSTRIËSË DHE TRANSPORTIT.
- PËRMIRËSIMI I STANDARDEVE TË EFIÇENCËS ENERGJETIKE, DUKE STIMULUAR INVESTIMET NË TEKNOLOGJI MODERNE DHE MË EFIÇENTE.
- PËRMBUSHJA E ANGAZHIMEVE NDËRKOMBËTARE, PËRFSHIRË ATO TË BASHKIMIT EVROPIAN PËR KLIMËN DHE ENERGJINË.
- REDUKTIMI I KOSTOVE TË ENERGJISË PËR QYTETARËT DHE BIZNESET, DUKE RRRITUR EFIÇENCËN DHE DUKE ULUR KONSUMIMIN E ENERGJISË.

Qeveria synon të krijojë një kornizë të te përditesuar të politikës së efikasitetit të energjisë që vendos objektiva kombëtare detyruese për kursimin e energjisë, përmirëson sistemin e mbikëqyrjes dhe raportimit të performancës energjetike, forcon rolin e institucioneve përgjegjëse dhe nxit investimet publike e private në efikasitetin e energjisë. Një ndër synimet kryesore është edhe përfshirja aktive e autoriteteve publike në shembullin e kursimit të energjisë dhe reduktimi i varfërisë energjetike për shtresat më të cenueshme. Objektivat e nivelit të lartë të qeverisë mbështeten duke kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm, uljen e emetimeve të gazrave serë dhe përmirësimin e kushteve të jetesës për qytetarët. Ajo gjithashtu ndihmon në mbështetje të angazhimeve të Shqipërisë për integrimin në Bashkimin Evropian dhe për plotësimin e kërkesave të politikave energjetike të BE-së.

Nisma e re për efikasitetin e energjisë, aktualisht në proces miratimi, e cila konsiston në vendosjen e objektivave të reja me ambicioze mbi kursimin e energjisë dhe përfshirje më të madhe institucionale, synon përputhje të plotë me direktivën e BE-së 2023/1791 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 13 Shtator 2023 “Për Efikasitetin Energjetike”.

Puna ekzistuese që është realizuar tashmë:

- Miratimi dhe zbatimi i Strategjisë Kombëtare të Energjisë përcakton objektivat dhe masat e mundshme për përdorimin e energjisë të rinovueshme, përmirësimin e efikasitetit të energjisë dhe dekarbonizimin e të gjithë ekonomisë.
- Plani Kombëtar për Energjinë dhe Klimën (PKEK) i cili është në përputhje me Direktivën EU për Energjinë dhe Klimën aprovuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave (VKM) Nr. 808, datë 21.12.2021.
- Miratimi dhe implementimi i Ligjit për efikasitetin e energjisë në vitin 2015, i cili ka për qëllim promovimin e masave për përmirësimin e efikasitetit të energjisë.
- Ndërtimi i bazës institucionale për Agjencinë për Efikasitetin e Energjisë dhe miratimi i platformës MVP për mbledhjen e të dhënave energjetike.
- Investime në burime të rinovueshme për të rritur përdorimin e energjisë nga burime të rinovueshme si hidrocentrale dhe energjia diellore, si dhe zhvillimi i teknologjive të reja për energjinë e pastër.
- Projekte ndërkombëtare dhe mbështetje teknike nepermjet marrëveshjeve dhe projekte me agjenci ndërkombëtare si Banka Botërore dhe Bashkimi Evropian për të mbështetur zhvillimin e energjisë së rinovueshme dhe përmirësimin e efikasitetit energjetike.

8. OBJEKTIVI I POLITIKËS

1. Vendosni objektiva që korrespondojnë me problemin dhe shkaqet e tij.

2. Sigurohuni që objektivat e vendosur të korrespondojnë me ato të dhëna në përmbledhjen ekzekutive, por më të detajuara.

3. Sigurohuni që objektivat janë specifike, të matshëm, të arritshëm, realë dhe në kohë.

Qëllimi i ndërhyrjes ligjore është krijimi i një kuadri të përditësuar, të qëndrueshëm dhe të zbatueshëm për eficientësi dhe energjisë, në përputhje me Direktivën (BE) 2023/1791, për të garantuar përdorimin e qëndrueshëm të energjisë dhe për të kontribuar në dekarbonizimin e sektorëve ekonomikë dhe përmirësimin e kushteve të jetesës së qytetarëve.

Bazuar në këtë qëllim, objektivat e politikës janë si më poshtë:

Objektivat kryesore që synohen të arrihen nëpërmjet kësaj politike në përputhje me skenarin bazë të PKEK-se janë:

1. Reduktimi i Konsumit Final të Energjisë perkundret skenarit baze te hartuar ne Strategjine e Energjine dhe ne PKEK (nepermjet rritjes se Efiçenca e Energjisë ne te gjithë sektoret: residencial, sherbime publike shenderore dhe bashkiake, industri, transport te pasagjereve dhe te mallrave, bujqësor, peshkim, etj) deri në 8.4% deri në vitin 2030.
2. Të arrihet një përqindje prej 54.4% të energjisë së rinovueshme në kërkesën finale për energji deri në vitin 2030 duke investuar ne te gjithë sektoret: residencial, sherbime publike shenderore dhe bashkiake, industri, transport te pasagjereve dhe te mallrave, bujqësor, peshkim, etj.
3. Reduktimi i shkarkimeve të GES-ve deri në masën 18.7% deri në vitin 2030.
4. Rritja e ndërgjegjësimit te qytetarëve dhe bizneseve nepermjet manaxhimit me te mire energjetik dhe rritjes se investimeve për efiçencën energjetike dhe përdorimin e energjisë së rinovueshme, përmes fushatave edukative dhe incentivave qeveritare, deri në vitin 2030.
5. Zhvillimi i mekanizmave efektivë për mbledhjen, verifikimin dhe raportimin e të dhënave të efiçencës së energjisë, përfshirë ngritjen e sistemeve të monitorimit dhe raportimit nga subjektet publike dhe private.
6. Përmirësimi i efiçencës energjetike në ndërtesat publike dhe sektorin e banimit nepermjet rinovimit çdo vit i të paktën 3% të sipërfaqes totale të ndërtesave publike dhe hartimi i një Plani Kombëtar për Rinovimin e Ndërtesave deri në fund të vitit 2026.
7. Reduktimi i numrit te familjeve ne nevoje nen-kushtet e varfërisë energjetike nepermjet identifikimit të konsumatorëve vulnerabël dhe mbështetja e tyre përmes subvencioneve (si nga niveli qendror ashtu edhe nga te gjitha Bashkite) per realizimin e masave te efiçencë se energjise deri në vitin 2027.
8. Nivelet specifike te vlerave te intensiteteve te energjise respektivisht per cdo sektor ekonomik (sipas vlerave te dhena ne tabelen 1) te reduktohen per te arritur vlerat respektive mestare sektoriale te vendeve te Bashkimit European te arrihen ne 10-vjecarin e ardhshem.

Të gjitha objektivat janë të përshtatshme për të adresuar problemet kryesore të efiçencës së energjisë në Shqipëri, dhe gjithashtu përputhen me objektivat e Bashkimit Evropian për energjinë dhe klimën. Realizimi i këtyre objektivave do të kontribuonte në një rritje të qëndrueshme të ekonomisë, përmirësimin e kushteve të jetesës dhe reduktimin e ndikimeve mjedisore dhe integrimin sa me shpejte te vendit tone drejt Bashkimit European.

9. PËRSHKRIMI I OPSIONEVE TË SHQYRTUARA

1. Përshkruani opsionin e status quo-së.

2. Identifikoni dhe përshkruani të gjitha opsionet e politikave që keni marrë parasysh.

3. Shpjegoni se si janë identifikuar opsionet e politikës.

Opsionet e mëposhtme janë vlerësuar në funksion të arritjes së objektivave të politikës:

“Opsioni 0 - status quo” – Ruajtja e situatës aktuale sipas standardeve të vendosura nepermjet kuadrit ligjor dhe rregullator të ligjit 124/2015 për efikasitetin e energjisë duke mos ndërhur me nisma të tjera legjislative. Ky opsion kërkon me pak investime fillestare, në të gjithë sektorët lidhur me efikasitetin e energjisë, krahasuar me opsionet e tjera, por nuk i zgjidh problemet e konstatuara, të cilat janë dhena në detaje në sesionet e mesipërme. Mosndërhurja me nisma të ndryshme rregullatore, fiskale dhe legjislative do të përkeqësojë në konsum me të lartë energjetik se të gjithë sektorët, kosto me të lartë financiare për zerin e kostos energjetike, rritje të kostos së jetesës, komfort me të ulët për familjet, kosto energjetike me të lartë dhe njëkohësisht konkurrencë me të ulët të bizneseve që kanë në zhvillim me të ulët ekonomik, mospërbashkimi i objektivave kombëtare dhe ndërkombëtare për dekarbonizimin dhe efikasitetin e energjisë si dhe do të krijojë një mospërshtatshmeri midis legjislacionit vendas me atë të Bashkimit Europian si dhe moszbatim të Marrëveshjeve Ndërkombëtare në të cilat aderohet vendi ynë.

“Opsioni 1 -Ndryshimi i ligjit ekzistues 124/2015 për efikasitetin e energjisë”– Ndërhurja me disa ndryshime dhe plotësime në ligjin ekzistues në fuqi 124/2015 “Për efikasitetin e energjisë” i ndryshuar tashmë dy herë të tjera në vitin 2019 dhe në vitin 2021. Vlen të theksohet se ndjekja e këtij opsioni paraqet me pak kosto në burime njerëzore, krahasuar me opsionin 1 dhe kërkon me pak kohë për tu realizuar. Por, nga ana tjetër kjo do të krijojë paqartësi dhe mungesë kuptueshmërie juridike, pasi ndryshimet e shumta do të bëjnë të pamundur kuptueshmërinë e ligjit dhe interpretimin e tij. Gjithashtu, ky opsion do të krijojë fragmentizim të legjislacionit. Gjithashtu, vlen të theksohet se ndjekja e këtij opsioni nuk do të rezultonte efektive, pasi ndryshimet dhe shtesat janë të konsiderueshme dhe do të krijojë konfuzion ligjor në kuptimin dhe zbatimin e dispozitave të kësaj nisme. Në kuadër të teknikës legjislative, duke qenë se ndërhurjet e synuara prekin me shumë se 70% të përmbajtjes së ligjit aktual, opsioni 1 nuk mund të përzgjidhet si opsion i vullnetshëm pasi do të krijojë konfuzion në kuptueshmërinë dhe qartësinë e kuadrit rregullator.

“Opsioni 2 –Miratimi i një ligji të ri” Hartimi i një ligji të ri, i cili do të përmirësojë kuadrin ligjor në fushën e efikasitetit të energjisë duke shfuqizuar Ligjin Nr. 124/2015 “Për efikasitetin e energjisë” i ndryshuar. Vlen të theksohet se ndjekja e këtij opsioni paraqet me kosto me të lartë në burime njerëzore dhe në investime, krahasuar me opsionin 1 dhe kërkon me shumë kohë për tu realizuar. Por, nga ana tjetër kjo do të krijojë qartësi dhe kuptueshmëri juridike dhe në të njëjtën kohë do të krijojë një klimë shumë të mirë në lidhje me investime në teknologji moderne të EE dhe RES, ulje të shpenzimeve energjetike për popullatën dhe bizneset, konkurrencë shumë me të lartë për bizneset, zhvillim shumë me të lartë ekonomik të vendit dhe plotësimin e angazhimeve ndërkombëtare të vendit të drejtimit të masave të marra për reduktimin e efektit të ngrohjes globale. Gjithashtu, ky opsion do të krijojë mjedis shumë të mirë meqenëse me pak gaze acide, do të shtonte vende pune dhe do të rriste aftësitë profesionale të të gjithë të punësuarve në këto profesione. Opsioni 2 rezulton të jetë më i favorshmi për t’u përzgjedhur pasi nëpërmjet hartimit, miratimit dhe zbatimit të një ligji të ri, sigurohet rregullimi i kësaj fushe në mënyrë shteruese. Gjithashtu, miratimi i një ligji të ri do të mundësojë përshtatjen dhe koherencën me politikën

ndërkombëtare mbi çështjen e efikasitetit të energjisë nepermjet përafritimit të Direktivës (BE) 2023/1791 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 13 shtator 2023 “Për Efikasitetin Energjetik”. Miratimi i një ligji të ri rrit edhe qëndrueshmërinë në kohë të politikës së miratuar, si dhe potencial për zbatim të saktë të saj.

“Opsioni 3- jo rregullator” Marrja e masave jo rregullatore nepermjet stimuljeve fiskale (reduktimi i nivelit të taksave), subvencione të drejtpërdrejta për familjet dhe bizneset, partneritete publike-private, fushatave ndërgjegjësuese për trajtimin e problemeve të konstatuara nuk do derivojnë në arritjen e plotësimin të objektivave kombëtar dhe pikësnyimeve ndërkombëtare mbi kursimin e energjisë dhe uljen e emetimit të gazeve me efekt sere. Eksperiencia e shume vendeve të BE-se, e vendit tone në të gjithë periudhën 2015-2025, si edhe disa vendeve të Ballkanit Perndimore ka treguar se masat e mesiperme janë vetëm kushte të nevojshme, por jo të mjaftueshme për arritjen e plote të objektivave të EE. Mos arritja e objektivave vetëm nepermjet masave të siperpëmendura i ka detyruar të gjitha vendet e BE-se të reformojnë komplet gjithë legjislativonin përkatës për të kaluar nga niveli i realizimit të masave në nivel gjithë-përfshirës duke vendosur në nivel të primar “eficenca e energjisë në krye”. Vendosja e efikasitetit të energjisë në krye, në të gjitha vendimarrjet, në çdo sektor ekonomik, ka filluar të sjellë rezultate në vendet e BE-se. Nderhyrja vetëm me masa jo rregullatore do të ishte kaotike pa vendosjen e standardeve të reja detyruese legjislative.

10. VLERËSIMI I OPSIONEVE/ANALIZIMI I NDIKIMEVE

1. *Identifikoni grupet e prekura.*
2. *Identifikoni llojet e ndikimeve për secilin grup të prekur, bëni dallimin midis ndikimeve të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta.*
3. *Për ndikimet e drejtpërdrejta:*
 1. *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet e drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
 2. *Analizoni nga ana sasiore ndikimet më të rëndësishme të drejtpërdrejta.*
 3. *Përcaktoni vlerën monetare të ndikimeve më të rëndësishme të drejtpërdrejta aty ku është e mundur (përdor tabelën në Aneksin 2/a të këtij dokumenti).*
 4. *Analizoni ndikimin mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (nëse ka).*
4. *Për ndikimet jo të drejtpërdrejta:*
 1. *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet jo të drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
 2. *Analizoni ndikimin mbi konkurrencën.*
5. *Diskutoni kufizimin e analizës:*
 1. *Jepni supozimet në të cilat janë bazuar parashikimet dhe risqet, të cilave ato u nënshtrohen.*
 2. *Tregoni se çfarë mund të pengojë realizimin e përfitimeve, të rrisë kostot ose të sjellë pasoja të papritura.*
6. *Përmbledhni vlerësimin e opsioneve:*
 1. *Paraqisni një pasqyrë përmbledhëse të të gjitha ndikimeve të opsioneve të analizuara.*
 2. *Shpjegoni se si ndikimet e të gjitha opsioneve të analizuara krahasohen me njëra-tjetrën.*
 3. *Paraqisni përlllogaritjet më të mira të përgjithshme neto të ndikimit me vlerë monetare të përcaktuar për çdo opsion (përdor tabelën në Aneksin 2/b të këtij dokumenti).*

Kjo politikë ka për qëllim përmirësimin e efikasitetit energjetik në të gjithë sektorët e ekonomisë, dhe paraqet ndikime të shumta direkte dhe indirekte në nivel ekonomik, mjedisor dhe shoqëror. Këtu janë disa nga ndikimet kryesore. Bazuar në këtë përmbajtje të politikës së re, grupet që preken nga zbatimi i tij janë si më poshtë:

- **Institucionet e qeverisjes qendrore** si përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e politikave të reja, përballen me sfida në përmbushjen e qëllimeve të kursimit të energjisë dhe klimës, si me çështjet e sigurisë së furnizimit me energji elektrike dhe uljen e konsumit të energjisë si dhe me presionin për të ulur emetimet konform angazhimeve ndërkombëtare. Aplikimi i Ligjit për efikasitetin energjetik ka ndikime të thella ekonomike për qeverinë dhe kërkon investime të konsiderueshme, por ofron mundësi për kursime afatgjata në energji, rritje të të ardhurave nga taksat dhe mundësi financimi, dhe përfitime të tjera të drejtpërdrejta për ekonominë dhe mjedisin. Për më tepër, nxitja e zhvillimit të sektorëve të rinovueshëm dhe përmirësimi i cilësisë së jetesës mund të kontribuojnë në rritjen ekonomike afatgjatë. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë është institucioni politikberes dhe monitorues mbi çështjet e efikasitetit energjetik, ndërsa Agjencia për Efikasitetin e Energjisë, Agjencia e Prokurimit Publik dhe Inspektorati për mbikqyrjen e tregut, i cili është në varësi të Ministrisë së Ekonomisë janë institucionet zbatuese të këtyre politikave. Një analizë sasimore e detajuar e tyre do të bëhet pas miratimit të nismës së re.

Këto ndikime janë të ndryshme dhe ndodhin në disa nivele, duke përfshirë shpenzime, mundësi të reja të të ardhurave dhe ndikime në politikë ekonomike dhe të zhvillimit. Disa nga ndikimet kryesore janë si më poshtë:

- **Organet e vetëqeverisjes vendore** (Bashkitë dhe njësitë administrative), të cilat duhet të kontribuojnë në përmbushjen objektive për dekarbonizim dhe efikasitet energjetik.
- **Bizneset** (Operatorët ekonomikë dhe ndërmarrjet e vogla dhe të mesme) përballen me mungesën e stimulave dhe të drejtësisë konkurruese në aksesin në tregun e shërbimeve energjetike. Shpenzimet e larta të energjisë ndikojnë në konkurrueshmërinë dhe fitimet.
- **Qytetarët** ekspozohen ndaj kostove të larta të energjisë dhe kushteve të dobëta të jetesës, veçanërisht grupet vulnerabël të cilët përjetojnë rritjen e kostove të energjisë dhe ndikimet negative në shëndet si dhe mungesë komforti.
- **Shoqëria civile** / OJF ka më pak mundësi të monitorojë dhe të ndërhyjë për interesin publik në çështje që lidhen me mjedisin dhe energjinë.

- **Qeveria: Ndikime të drejtpërdrejta**

Perfitimi shtesë i kursimeve të energjisë nuk do të kufizohet vetëm nga ana e konsumatorëve, por do të përhapet gjithashtu në ekonomi në tërësi. Perfitimet shtesë me se shpeshti klasifikohen në tre grupe: mjedisore, ekonomike dhe sociale. Grupi i parë përmban ndikimet me të rëndësishme dhe të drejtpërdrejta të efikasitetit të energjisë, si kursimet e energjisë dhe reduktimet e emetimeve të gazeve me efekt sere. Grupi i dytë përfshin, ndër të tjera, ndikimet pozitive makroekonomike në rritjen ekonomike, inovacionin dhe konkurrencën, si dhe varesinë nga importi. Grupi i tretë i ndikimeve mbulon aspekte të tilla si perfitimet shëndetësore, reduktimi i varferisë dhe punësimi. Megjithatë perfitimet shtesë të masave të efikasitetit të energjisë janë të padiskutueshme, ato jo gjithmonë mund të maten dhe të kuantifikohen.

Pavarësisht rritjes së përdorimit të burimeve vendase të energjisë, si energjia diellore dhe biomasa, Shqipëria varet nga 10-25% importet e energjisë elektrike dhe 100% importet nga nen-produktet e naftës, të cilat në përgjithësi përbenin rreth 35% të furnizimit të saj me energji primare në vitin 2023. Futja e masave EE/RES mund të rrisë sigurinë e energjisë duke: (a) reduktuar importet e nen-produkteve të naftës; (b) reduktimin e konsumit të druve të zjarrit dhe në këtë mënyrë parandalimin e shpyllëzimit; dhe (c) Draft-Raporti i Vlerësimit të Ndikimit

minimizimin e volumit te importeve te energjise elektrike, (d) rritjen e perdorimit te BRE, (e) arritjen e dekarbonizimit te plote te stokut te ndertesave, (f) dhe arritjen e objektivave perkatese te NECP ne tre sektore te ndertesave dhe ne kete menyre reduktimi i nevojës per subvencione qeveritare. Ne baze te standardeve nderkombetare, kostoja e zbatimit te masave EE eshte afersisht sa gjysma e koston se ndertimit te objekteve te reja te furnizimit me energji elektrike. Kursimi i energjise do te sjelle ulje te konsumit total te energjise primare me 15.3% dhe ulje te importeve te energjise me 26-28%.

Permiresimi i bilancit fiskal eshte nje prioritet i larte per Qeverine Shqiptare dhe Masat EE/BRE perfaqesojne nje mundesi per qeverine dhe sektorin publik per te reduktuar shpenzimet e buxhetit te energjise dhe kjo tregon se sektori publik mund te kurseje nivele te larta te buxhetit duke futur masat EE/BRE ne ndertesate. Te gjitha masat EE/BRE qe do te futen do te jene masa me kosto efektive sepse investimet e bera per te permiresuar objektet qeveritare do te veteshlyhen nepermjet kursimeve ne nivel kombetar. Investimet ne EE kane nje ndikim pozitiv ekonomik pasi ato kontribuojne ne zhvillimin e nje industrie moderne qe ofron vende pune dhe nje sere mundesish per zhvillimin e biznesit. Ato gjenerojne gjithashtu te ardhura nga rritja e taksimit per punen e ndertimit te kerkuar per zbatimin e masave EE, gje qe krijon nje situatë pozitive, ku nevoja e Qeverise Shqiptare per te optimizuar te ardhurat tatimore mbeshtetet nga zhvillimi i nje tregu EE me perfitimet e tij te ndryshme sociale dhe mjedisore.

Kursimi i energjise con ne reduktimin e emetimeve te gazeve me efekt sere. Keto llogariten sipas llojit te energjise se kursyer dhe faktorit perkates te emetimit per llojin e energjise ne fjale. Kursimet e emetimeve maten ne ton ekuivalent CO₂. Kursimet e CO₂ llogariten duke shumezuar kursimet totale te energjise per sektor me faktorin mesatar te emetimeve per sektorin perkates (tCO₂/toe). Kursimet prej 335 ktoe/vit pritet te rezultojne ne nje reduktim te emetimeve te gazeve me efekt sere₂ me 1246 kt ekuivalent CO₂.

a. Për qeverinë:

Te ardhura dhe përfitime (Pozitive): - Përmirësimi i kapaciteteve të administratës: Implementimi i një ligji të ri do të kërkojë zhvillimin e kapaciteteve të administratës shtetërore për zbatimin e tij, duke përfshirë rritjen e kompetencave dhe trajnimin e stafit.

-Përmirësimi i angazhimeve ndërkombëtare: Shqipëria do të përmbushë angazhimet e saj për dekarbonizimin dhe rritjen e efikasitetit energjetik, që është një synim i rëndësishëm në kuadër të marrëveshjeve ndërkombëtare si Marrëveshja e Parisit.

Shpenzime dhe Investime Publike (Negative): - Kosto për administratën shtetërore: Përmirësimi i kapaciteteve, nevoja për ngritje e sistemit të raportimit, përmirësimi në monitorim dhe transparencë mund të kërkojë alokim të burimeve shtesë që mund të kenë një kosto të konsiderueshme për buxhetin shtetëror.

-Nevoja për për autoritete inspektuese: Zbatimi i rregullave të reja do të kërkojë më shumë inspektime dhe mbikëqyrje, që mund të rrisin ngarkesën për autoritetet shtetërore.

➤ **Organet e vetëqeverisjes vendore:** Përballja me sfida në përmbushjen e qëllimeve për uljen e konsumit të energjisë si dhe me presionin për të ulur emetimet konform angazhimeve ndërkombëtare.

- Në zbatim të ligjit do të rritet kërkesa për rinovimin e ndërtesave publike si dhe lind nevoja për ngritjen e sistemit të monitorimit, ngritjen e strukturave zbatuese dhe rritje kapacitetesh për ushtrimin e funksioneve të reja.

b. Bizneset:

Te ardhura dhe përfitime (Pozitive): - Rritje e mundësive për kursime: Përdorimi i teknologjive dhe metodave më të mira për efikasitetin e energjisë do të çojë në reduktimin e kostove operative të energjisë për bizneset, duke i mundësuar atyre të kursejnë më shumë në energji.

-Mbështetje dhe subvencione: Mundësitë për subvencione dhe mbështetje financiare nga qeveria ose BE mund të ndihmojnë bizneset të investojnë në përmirësimin e efikasitetit energjetik të ndërtesave dhe infrastrukturës.

Shpenzime dhe Investime Publike (Negative): -Kosto fillestare të larta si rrjedhim i detyrimeve për raportim, auditime energjetike, investime në teknologji të efikasitetit. Për bizneset, investimi në rinovimin e ndërtesave dhe përmirësimin teknologjik për të përmbushur standardet e reja të efikasitetit energjetik mund të ketë kosto të konsiderueshme fillestare, që mund të jenë një barrë financiare, veçanërisht për Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM-të).

-Rreziku i humbjes së konkurrencës: Ndërmarrjet që nuk mund të përmbushin kërkesat e reja mund të përballen me humbje të konkurrencës në treg, duke u shndërruar në një ndalesë për disa sektore të caktuar

c. Qytetarët:

Te ardhura dhe përfitime (Pozitive): - Reduktimi i kostos së energjisë: Me zbatimin e standardeve të reja, qytetarët do të shohin një ulje të kostos mujore për energjinë, për shkak të performancës më të mirë të ndërtesave dhe sistemeve të energjisë.

-Përmirësimi i kushteve të jetesës: Ndërtesat me efikasitet të përmirësuar do të ofrojnë kushte më të mira për jetesë, si ngrohje dhe ftohje më të qëndrueshme dhe më të lira.

Shpenzime dhe Investime Publike (Negative): -Kosto të larta fillestare: Për qytetarët që jetojnë në ndërtesa të vjetra dhe që duhet të investojnë në përmirësimin e performancës energjetike, mund të kenë kosto të larta për renovimin e ndërtesave të tyre, megjithëse ato do të kompensohen me kursimet afatgjata.

-Përballja me mundësinë e rritjes së çmimeve të shërbimeve: Disa qytetarë mund të përballen me rritje të çmimeve për energjinë gjatë periudhës së kalimit, derisa mund të implementohen masat e reja.

10.1.1. Ndikimet e Jo të drejta për drejta

Grimcat, të cilat janë një ndotes i ajrit, shkaktojnë 3.3 miliona vdekje të parakohshme në vit në mbare botën. Nderkohe, është e rëndësishme të përmendet se nuk ka të dhëna të raportuara për shkaqet e vdekjeve të parakohshme në Shqipëri në sektoret e stokut të ndërtesave. Efekti i reduktimit të ndotjes së ajrit si rezultat i kursimit të energjisë raportohet sipas llojit të energjisë së kursyer dhe faktoreve të caktuar të emetimit specifik për atë lloj energjie. Reduktimet e emetimit vlerësohen për ndotesit kryesorë të meposhtem: oksidet e azotit (NOx), oksidet e squfurit (SOx), grimcat e imta (PM2.5 dhe PM10) dhe monoksidi i karbonit (CO). Megjithatë, është shumë e rëndësishme të vihet re se stoku i ndërtesave në Shqipëri konsumon 22.42% të Diesel/LPG-së dhe 17.02% Dru Zjarri është shumë më pak krahasuar me sektorin e transportit, i cili është kryesori pasi konsumon 2.53 here më shumë (706 ktoe) krahasuar me stokun e ndërtesave (që konsumon 282 ktoe dru/LPG dhe diesel). Skenari i dekarbonizimit të plotë do të reduktojë shumë më tepër ndotjen e ajrit lokal, pasi energjia elektrike nga BRE, energjia diellore dhe teknologjite efikente të biomases do të kontribuojnë deri në 100% deri në vitin 2050.

Përfitimet shëndetësore që lidhen me zbatimin e masave të efikasitetit të energjisë janë indirekte dhe lidhen me reduktimin e emetimit të demshëm në ajër (oksidet e squfurit dhe azotit, grimcat e imta, etj.) dhe me përmirësimin e komfortit të ngrohjes në ndërtesa. Kjo çon në shkallë më të ulët të sëmundshmerisë dhe vdekshmerisë. Efekti i sëmundshmerisë dhe vdekshmerisë me të ulët mund të merret parasysh edhe në ditët shtesë të punës dhe për këtë arsye ka një ekuivalent monetar. Ky parameter nuk është i mundur të llogaritet për Shqipërinë për shkak të mungesës së të dhënave dhe konsiderohet vetëm si përfitim cilësor

shtese.

Perfitimet ekonomike jo te drejtperdrejtaq jane te rendesishme per politikat e eficences se energjise, te cilat duhet te zbatohen ne nje menyre me kosto efektive. Vleresimi i perfitimeve ekonomike shtese i ben investimet ne eficencen e energjise me terheqese dhe redukton ndjeshem kohen e nevojshme per te rikuperuar koston e investimit. Zhvillimi i teknologjive te eficences se energjise ka nje efekt pozitiv ne ekonomine dhe konkurrencen e saj. Ashtu si me inovacionin, ky tregues nuk lidhet drejtperdrejt me kursimet e arritura te energjise dhe eshte i veshtire per t'u vleresuar. Megjithate, inovacioni do te jete pothuajse i paperfillshem ne rastin e Shqiperise pasi nje pjese e madhe e pajisjeve EE/RES importohen per momentin.

Efektet e punesimit percaktohen nga dy faktore kryesore: Investimet ne EE/BRE krijojne vende pune ne instalimet e tyre dhe ne industrine qe prodhon produktet dhe ofron sherbimet perkatese, dhe kursimet e energjise arriten kerkese me te ulet per produkte energjitike ne terma afatgjate. Nga ana tjetere, kerkesa me e ulet ka nje efekt ne vleren e shtuar te prodhuar - nje ndryshim qe ndikon punesimin ne sektorin perkates. Shperndarja e EE/RES ne sektorin e ndertesave eshte nje mundesi strategjike per pune. Ndersa teknologjia perparon, do te gjenden mundesi te reja per te permiresuar profilin energjistik te BE-se dhe per te reduktuar varesine nga importi. Ne vitin 2050, kerkesa evropiane dhe globale per aftesi ne eficencen energjetike te ndertesave do te jete ende e larte dhe e perhershme – megjithese ato nuk do te shihen me thjesht si pune te eficences se energjise. Perkundrazi, ato do te jene bere pjese e peizazhit te aktivitetit te perditshem brenda nje ekonomie me emetime te uleta karboni. Punet duhet te shihen ne aspektin e mundesive te biznesit, shume prej te cilave jane novatore dhe te reja. Ato ekzistojne per kompanite e sherbimeve te energjise, per fondet e investimeve, per kompanite e rinovimit, per shitjen dhe shperndarjen, dhe shume te tjera. Do te kete shume me teper mundesi te nderlidhura ne Teknologjine e Informacionit dhe Komunikimit (TIK) pasi keto jane te perfshira ne sistemet e menaxhimit te ndertesave.

Sigurisht, per te pare gamen e plote te mundesive te punes, kerkohet nje game e gjere aftesish. Ne prodhim, ndertim dhe rinovim, shperndarje dhe fusha te tjera, krahas puneve shume te kualifikuara dhe teknike, ka gjithashtu shume pozicione te disponueshme per nje fuqi punetore me pak te kualifikuar, qe aktualisht vuan me se shumti nga nivelet e larta te papunesise. Ne pjesen me te madhe, tregu i punes eshte nje vlere e mire e shtuar per ekonomine. Instalimi i elementeve dhe teknologjive me eficence energjie ka tendencen te jete me shume pune intensive sesa prodhimi i tyre, keshtu qe kur politika kerkon fusha te rritjes, eficenca energjitike e ndertesave duhet te jete nje nga prioritetet kryesore. Zhvillimi i vendeve te punes ne eficencen energjitike te ndertesave eshte nje fushe kyce ku rritja ekonomike sjell reduktimin e saj ne emetimet e karbonit dhe rritjen e sigurise energjitike. Analiza tregon se vendet e reja te punes qe do te krijohen nga rinovimi EE/BRE te ndertesave rezidenciale, publike, private, industrine dhe stokut total do te jene perkatesisht 8,291, 3,666, 5,495 dhe 20,452 .

a.Për qeverinë

Te ardhura dhe përfitime (Pozitive): - Përmirësimi i imazhit ndërkombëtar: Implementimi i një ligji të ri për efikasitetin e energjisë, në përputhje me direktivat e BE-së, mund të rrisë imazhin e Shqipërisë si një shtet i angazhuar për rritjen e sigurisë së furnizimit me energji, rritjes së qëndrueshmërisë dhe mbrojtjes të mjedisit, duke kontribuar në përmbushjen e marrëveshjeve ndërkombëtare për klimën dhe dekarbonizimin.

-Përmirësimi i marrëdhënieve ndërkombëtare dhe investimeve: Përshtatja e ligjit me standardet ndërkombëtare mund të rrisë mundësitë për të tërhequr investime të huaja, sidomos ato në energji të rinovueshme dhe teknologji të gjelbra.

Shpenzime dhe Investime Publike (Negative)- Sfidat e administratës dhe zbatimit të ligjit: Pas miratimit të ligjit të ri, qeveria mund të përballlet me sfida në implementimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të tij, duke kërkuar burime dhe kapacitete të konsiderueshme për monitorimin e sektorëve të ndryshëm që duhet të përshtaten me ligjin.

-Rritja e presioneve për ndihmë dhe mbështetje financiare: Mund të ketë kërkesa për fonde shtesë për të mbështetur qytetarët dhe bizneset në përputhje me kërkesat e reja, duke e bërë më të vështirë mbajtjen e bilancit të buxhetit.

b. Organet e vetëqeverisjes vendore

Te ardhura dhe përfitime (Pozitive): - Rritje e kapaciteteve institucionale në nivel lokal si rrjedhim i zbatimit të masave të efikasitetit kërkon bashkëpunim ndërsektorial (urbanistikë, financë, mjedis), çka nxit bashkitë të ristrukturojnë dhe të forcojnë kapacitetet njerëzore dhe organizative.

- Përmirësimi i imazhit të qeverisjes vendore: Bashkitë që zbatojnë me sukses masa efikasiteti energjetike do të perceptohen më pozitivisht nga komuniteti dhe donatorët, duke përfituar më shumë besueshmëri për projekte të tjera.
- Zhvillimi i projekteve të reja investimi dhe akses në fonde: Ligji i ri do t'u hapë rrugë bashkive për të aplikuar më gjerësisht në fonde ndërkombëtare (si IPA III, BERZH, GIZ, BE për Energjinë), duke krijuar mundësi investimesh në infrastrukturë publike (ndërtesa, ndriçim rrugor, ngrohje qendrore etj.)
- Nxitje e zhvillimit ekonomik vendor: Kërkesat për auditime, rinovime dhe shërbime EPC mund të gjenerojnë treg të ri për ndërmarrjet lokale, duke përmirësuar ekonominë vendore.
- Reduktimi i ndotjes urbane dhe përmirësimi i cilësisë së ajrit: Masa si rinovimi i ndërtesave dhe sistemet e ndriçimit të zgjuar ulin konsumin e energjisë dhe ndotjen, sidomos në qytetet me ajër të ndotur si Tirana, Elbasani, Durrësi etj.

Shpenzime dhe Investime Publike (Negative): -Mungesa e kapaciteteve teknike dhe njerëzore mund të kufizojë përfitimin e fondeve dhe zbatimin cilësor të masave;

- Buxhete të kufizuara bashkiake që mund të pasojnë me investimet fillestare të munguara ose të vonuara, duke reduktuar përfitimet afatgjata;
- Bashkëpunimi i dobët me sektorin privat.

c. Bizneset:

Te ardhura dhe përfitime (Pozitive):- Zhvillimi i mundësive të reja: Bizneset mund të shohin mundësi për zhvillim dhe inovacion, veçanërisht në sektorët e energjisë së rinovueshme dhe efikasitetit energjetike, si prodhimi i produkteve të reja që përmbushin kërkesat e ligjit.

-Rritja e mundësive të bashkëpunimit dhe investimeve: Njëpërmjet përmirësimit të kushteve të biznesit dhe zhvillimit të mëtejshëm të industrive të gjelbra, mund të krijohen mundësi të reja për bizneset që ofrojnë produkte dhe shërbime të energjisë së pastër dhe efikasiteti.

Draft-Raporti i Vlerësimit të Ndikimit

Shpenzime dhe Investime Publike (Negative): - Rritja e kostove fillestare të adaptimit: Bizneset do të kenë nevojë të investojnë për të përmbushur kërkesat e ligjit të ri, çka mund të çojë në rritje të kostove të operimit dhe mund të shkaktojë vështirësi për ato që kanë burime financiare të kufizuara.

-Pasiguri në aplikimin e ligjit: Shpesh mund të ketë pasiguri dhe konfuzion në lidhje me zbatimin e detyrimeve ligjore, që mund të ndikojnë në aktivitetin ekonomik të bizneseve, veçanërisht atyre që janë të vogla dhe të mesme.

d. Qytetarët:

Te ardhura dhe përfitime (Pozitive):- Përmirësimi i kushteve të jetesës: Implementimi i kërkesave të ligjit mund të sjellë kushte më të mira jetese për qytetarët, përmes përdorimit të teknologjive më efçente energjetikisht dhe një ambient më të pastër.

-**Arsimimi, kualifikimi dhe ndërgjegjësimi me teknologjite e reja te EE/RES:** Kjo mund të krijojë mundësi për qytetarët dhe ekspertet energjetike për të mësuar rreth energjisë së qëndrueshme, duke i inkurajuar të ndërmarrin hapa më të ndërgjegjshëm për kursimin e energjisë dhe përdorimin e burimeve të rinovueshme.

Shpenzime dhe Investime Publike (Negative): - Ngarkesa financiare afatshkurtër: Qytetarët mund të ndihen të ngarkuar financiarisht nga kërkesat e reja për përmirësimin e efçencës energjetike në shtëpitë e tyre, siç është investimi në izolim më të mirë ose pajisje të reja energjetike, duke krijuar vështirësi për ata që kanë burime të kufizuara financiare.

-**Rritja e çmimeve të shërbimeve:** Nëse bizneset do të rrisin çmimet për të përmbushur kërkesat e ligjit të ri, qytetarët dhe ekspertet energjetike mund të përballen me rritje të çmimeve të energjisë dhe shërbimeve të tjera të lidhura me energjinë, çka mund të ndikojë negativisht në fuqinë e tyre blerëse.

e. Ndikimi mbi konkurrencën lokale

Ndikimet Mjedisore:

Nisma, ka ndikime të rëndësishme pozitive në mjedis, pasi përmirësimi i effiçences energjetike të ndërtesave dhe në reduktimin e emetimeve të gazeve me efekt serë. Nepermjet kesaj politike kontribuohet në uljen e emetimeve të gazeve serë, nxit përdorimin e energjisë së rinovueshme, përmirëson cilësinë e ajrit dhe ndihmon në përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike. Ky ligj është një hap i rëndësishëm drejt krijimit të një mjedisi të qëndrueshëm dhe të shëndetshëm për brezat e ardhshëm. Ja disa nga ndikimet mjedisore kryesore të këtij ligji:

- Reduktimi i emetimeve te gazeve me efekt sere;
- **Nxitja e Përdorimit të Energjisë së Rinovueshme;**
- **Përmirësimi i Cilësisë së Ajrit dhe Mjedisit.**

- Ndikimet Sociale:

Politika e re ka ndikime sociale të rëndësishme, pasi përmirëson cilësinë e jetesës dhe ndihmon në krijimin e kushteve më të mira për individët dhe komunitetet. Ndikimet sociale të kesaj politike përfshijnë një gamë të gjerë, si rritja e cilësisë së jetesës, përmirësimi i kushteve të punës, dhe siguria sociale e individëve, veçanërisht për ata që janë më të ndjeshëm ndaj ndryshimeve klimatike dhe kushteve jo te mira të ndërtesave te amortizuara.

f. Përmirësimi i Kushteve të Jetesës

- **Kushte më të mira të mjedisit te brendshem te ndërteses:** Përmirësimi i effiçences energjetike të ndërtesave, përmes izolimit, sistemeve të ngrohjes dhe ftohjes më të mira dhe

përdorimit të energjisë së rinovueshme, çon në kushte më të mira të jetesës. Ndërtesat me efiçence të lartë mbajnë temperatura më të qëndrueshme, duke ofruar një mjedis të rehatshëm dhe të shëndetshëm për ata që jetojnë në to.

- **Reduktimi i energjise per ngrohje dhe ftohje:** Qytetarët që jetojnë në ndërtesa me performance të dobët nga pikëpamja energjetike mund të përballen me temperaturat ekstreme, si ngrohja e tepërt gjatë verës ose ftohja e tepruar gjatë dimrit. Përmirësimi i efiçences energjetike ndihmon në zvogëlimin e këtyre efekteve, duke përmirësuar shëndetin dhe mirëqenien e individëve.

g. Përmirësimi i Shëndetit Publik

- **Reduktimi i ndotjes:** Reduktimi i konsumit të energjisë dhe përdorimi i sistemeve më të avancuara ndihmojnë në përmirësimin e cilësisë së ajrit, kjo është veçanërisht e rëndësishme për individët që vuajnë nga probleme të frymëmarrjes, si astma dhe alergjitë, pasi një ajër i pastër është thelbësor për shëndetin e tyre.
- **Mbrojtja kundër valëve të nxehtësisë dhe ftohjes së tepruar:** Në periudhat e ngrohjes ekstreme, ndërtesat që përmbushin standardet energjetike mund të ofrojnë një mbrojtje më të mirë kundër temperaturave të larta, duke mbajtur mjedisin të freskët dhe të rehatshëm. Kjo është e rëndësishme, veçanërisht për grupet më vulnerabel si të moshuarit dhe ata me kushte shëndetësore ekzistuese.

h. Reduktimi i Varfërisë Energjetike

- **Mundësitë për kursime financiare:** Ndërsa politika inkurajon përmirësimin e efiçences energjetike, ky përmirësim mund të çojë në uljen e kostos së energjisë për individët dhe familjet. Ata që përjetojnë varfëri energjetike, që shpesh duhet të zgjedhin mes ngrohjes dhe ushqimit, mund të përfitojnë nga kursimet e energjisë që mund të vijë si rezultat i përmirësimit të efiçencës energjetike.
- **Ndihma për shtresat më të varfra:** Familjet me të ardhura të ulëta, që zakonisht jetojnë në ndërtesa me efiçence të ulët energjetik, mund të ndihmohen nga subvencionet dhe mbështetjet financiare për të përmirësuar kushtet e jetesës së tyre. Kjo mund të kontribuojë në uljen e varfërisë energjetike dhe përmirësimin e cilësisë së jetesës për ata që janë më të prekshëm.

j. Përmirësimi i Cilësisë së Punësimit

- **Kushtet e punës në ndërtesa të përmirësuara:** Përdorimi i teknologjive të avancuara për efiçencën energjetike, si sisteme më të mira të ngrohjes dhe ftohjes, ventilim më të mirë dhe ndriçim të efiçent, përmirësojnë cilësinë e kushteve të punës për punonjësit në ndërtesa. Një ambient pune i rehatshëm ka ndikim pozitiv në produktivitetin e punonjësve dhe ndihmon në ruajtjen e shëndetit të tyre.
- **Shëndeti dhe mirëqenia e punonjësve:** Ndërtesat që janë të optimizuara energjetikisht mund të ndihmojnë në reduktimin e stresit termik dhe sëmundjeve të tjera që mund të shkaktohen nga kushte të këqija të punës, duke përfshirë lodhjen dhe probleme të tjera shëndetësore që lidhen me temperaturat ekstreme dhe ajrin e ndotur.

k. Krijimi i Mundësive të Reja për Punësim

- **Rritja e kërkesës për punë të specializuara:** Zbatimi i politikës për performancën energjetike do të krijojë mundësi punësimi në sektorët e ndërtimit dhe instalimit të sistemeve energjetike të rinovueshme. Kjo mund të ndihmojë në krijimin e vendeve të reja pune për profesionistët e kualifikuar, si inxhinierë të energjisë, specialistë të teknologjisë së informacionit, dhe punonjës të ndërtimit.
- **Kursime për shpenzimet sociale:** Përmirësimi i performancës energjetike mund të ulë nevojën për ndihma financiare dhe mbështetje sociale për ata që kanë vështirësi të përballojnë shpenzimet e energjisë. Ky është një hap i rëndësishëm drejt përmirësimit të barazisë sociale dhe krijimit të mundësive të qëndrueshme për individët dhe familjet që janë të prekshëm nga varfëria energjetike.

Draft-Raporti i Vlerësimit të Ndikimit

I. Rritja e Ndërgjegjësimit dhe Edukimit për Qëndrueshmërinë

- **Ndikimi te brezat e ardhshem:** Zbatimi I politikës mund të nxisë ndërgjegjësimin për rëndësinë e kursimit të energjisë dhe mbrojtjen e mjedisit tek brezat e ardhshem. Edukimi për ndërtimin dhe përdorimin e ndërtesave me efikasitet të lartë energjetike mund të krijojë një kulturë të qëndrueshmërisë dhe një shoqëri më të vetëdijshme për ndikimin e energjisë dhe ndotjes në jetën e përditshme.

Për sa më sipër, mund të përmendim disa nga kufizimet e analizës së mësipërme:

Kryerja e një analize të mirëfilltë sasiore dhe monetare mbi ndikimet ekonomike dhe financiare të zbatimit të ligjit të ri për efikasitetin e energjisë është aktualisht e pamundur, për shkak të këtyre arsyeve objektive:

kryerja e një analize të mirëfilltë sasiore dhe të vlerësuar monetarisht mbi ndikimet ekonomike dhe financiare të projektligjit “për efikasitetin e energjisë” është aktualisht e pamundur, për disa arsye objektive dhe të justifikueshme. së pari, mungojnë të dhënat e detajuara sektoriale dhe institucionale për konsumin e energjisë, veçanërisht në nivel lokal dhe për ndërtesat publike, që janë të nevojshme për të modeluar ndikimet e masave të reja. së dyti, ligji ekzistues nr. 124/2015 nuk është shoqëruar me një analizë të plotë financiare të zbatimit, duke e bërë të vështirë ndërtimin e një skeme krahasuese të kostove dhe përfitimeve. gjithashtu, struktura shumë e ndryshme teknike dhe financiare mes bashkive dhe operatorëve ekonomikë e bën të pamundur standardizimin e ndikimeve në këtë fazë. një pjesë e konsiderueshme e kostove të zbatimit do të varet nga aktet nënligjore që do të përcaktojnë kriteret teknike, metodat e auditimit dhe detyrimet konkrete për subjektet. po ashtu, përfitimet më të mëdha nga masat e efikasitetit shfaqen në periudha afatgjata (5–10 vjeçare), për të cilat nuk ka ende modele të gatshme vlerësimi në nivel kombëtar.

Megjithatë, sapo të miratohen aktet nënligjore përkatëse dhe të funksionalizohet sistemi kombëtar i raportimit dhe monitorimit të energjisë, do të ndërmerret një analizë dinamike dhe e detajuar e ndikimeve, përfshirë vlerësimet monetare mbi buxhetin publik, bizneset dhe qytetarët. kjo do të mundësojë përmirësimin progresiv të politikës dhe alokimin më eficient të burimeve.

11. ARSYETIMI I OPSIONIT TË PREFERUAR

1. Zgjidhni opsionin e preferuar, bazuar në analizë.
2. Shpjegoni arsyetimin tuaj.

Opsioni i preferuar: Opsioni 2 - Miratimi i një ligji të ri për efikasitetin energjetike.

Opsioni i preferuar është hartimi dhe miratimi i një ligji të ri për efikasitetin e energjisë, që transponon plotësisht Direktivën (BE) 2023/1791 të Parlamentit dhe Këshillit Evropian. Ky opsion u zgjodh si më i përshtatshmi në raport me alternativat e tjera të mundshme, si ndryshimi i pjesshëm i ligjit ekzistues nr. 124/2015 apo ruajtja e status quo-së, për disa arsye themelore.

Së pari, direktiva e re sjell një qasje tërësisht të përditësuar dhe gjithëpërfshirëse për mënyrën se si shtetet anëtare (dhe vendet në proces integrimi si Shqipëria) duhet të adresojnë objektivat e reja të BE-së për reduktimin e konsumit të energjisë deri në vitin 2030. Ligji ekzistues nuk parashikon mekanizma të tillë si: përcaktimi i objektivave detyruese në nivel kombëtar dhe sektorial, përfshirja e konceptit të “efikasitetit të energjisë si burim energjie”, krijimin e fondit të efikasitetit të energjisë, auditimet e detyrueshme për sektorin publik, detyrimet për bashkitë, etj.

Së dyti, hartimi i një ligji të ri siguron koherencë të plotë ligjore dhe përputhshmëri me *acquis communautaire* të BE-së, duke shmangur interpretimet e dyfishta apo zgjidhjet gjysmake. Ky qasje do të lehtësojë zbatimin, raportimin dhe monitorimin e progresit drejt objektivave të përcaktuara nga BE-ja dhe Komuniteti i Energjisë.

Së treti, ligji i ri do të shoqërohet me një kuadër të përmirësuar institucional dhe instrumente më efektive financiare dhe teknike, që parashikohet të sjellin përfitime afatgjata në formën e kursimeve të energjisë, reduktimit të varësisë nga importi, zvogëlimin të emetimeve të gazeve serrë dhe përmirësimit të performancës së ndërtesave publike dhe private.

Së katërti, me miratimi e një ligji të ri për eficientë energjetike shmanget fragmentizimin e legjislacionit dhe pakuptueshmëria dhe paqartësia në interpretimin e tij, pasi ndryshime të shumta do ta bënin të pakuptueshem.

Bazuar në këto elemente, opsioni i hartimit të një ligji të ri përbën alternativën më të efektshme, më të përputhshme me angazhimet ndërkombëtare dhe më të qëndrueshme nga pikëpamja afatgjatë e zhvillimit të qëndrueshëm dhe tranzicionit të gjelbër të vendit.

12. ÇËSHTJE TË ZBATIMIT

1. *Shpjegoni se cila strukturë do të jetë përgjegjëse për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
2. *Shpjegoni pengesat e mundshme për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
3. *Përshkruani masat që do të ndërmerren gjatë zbatimit për të arritur qëllimet e politikës.*

Institucionet përgjegjëse për zbatimin e opsionit të preferuar janë:

- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), është institucioni përgjegjës për hartimin dhe monitorimin e politikave të eficientës së energjisë.
- Agjencia për Eficencën e Energjisë (AEE), krijuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 852, datë 7.12.2016 "Për ngritjen, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Efiçencës së Energjisë" dhe hyri në funksion në fund të vitit 2018 dhe përbëhet nga katër sektorë pjesë e Drejtorisë Teknike: 1) Sektori i programeve dhe analizave të efiçencës, 2) Sektori i auditimeve dhe certifikimeve, 3) Sektori i shërbimeve energjetike, 4) sektori i menaxhimit dhe monitorimit të projekteve dhe Njësia e financa dhe shërbime mbështetëse, (gjithsej 20 punonjës).

AEE zbaton dhe monitoron politikat për eficientë të energjisë si dhe propozon dhe ndjek një sërë projektesh që konsistojnë në përmirësimin e eficientës së energjisë në ndërtesa. Aktualisht, disa projekte të efiçencës së energjisë janë në zhvillim e sipër përmes buxhetit të shtetit, instrumenteve financiare si Projektet IPA ose marrëveshjeve të tjera financiare ose nëpërmjet donatorëve.

- Insitucionet e qeverisjes vendore për zbatimin dhe monitorimin e politikave lokale mbi eficientë të energjisë.
- Agjencia përgjegjëse për Burimet e Rinovueshme të Energjisë përgjegjëse për zbatimin dhe monitorimin e politikave mbi burimet e rinovueshme të energjisë.
- Agjencia për Prokurimin Publik e cila është përgjegjëse për blerjet e produkteve eficientë për institucionet publike.
- Inspektorati i mbikqyrjes së tregut i cili është përgjegjës për kontrollin në treg të produkteve me ndikim në energji dhe disponueshmërinë e informacionit mbi konsumin e energjisë së pajisjes.

Pengesat e mundshme për zbatimin e opsionit të zgjedhur janë:

1. Mosmiratimi në kohë i ligjit, për arsye nga më të ndryshmet politike apo të tjera;

Draft-Raporti i Vlerësimit të Ndikimit

2. Vonesa në miratimin e akteve nënligjore të parashikuara nga ligji tej afateve ligjore apo edhe mosmiratimi i tyre;
3. Vonesa në ngritjen dhe forcimin e kapaciteteve njerezore të autoriteteve perkatese të ngarkuara me zbatimin e ligjit;
4. Pengesat financiare (p.sh., mungesa e fondeve të mjaftueshme për zbatim).
5. Vështirësitë teknike, si mungesa e teknologjisë për të përmbushur standardet e reja.
6. Sfida në koordinimin mes institucioneve përgjegjëse.
7. Mungese e stafit të kualifikuar në institucionet zbatuese

MIE në kuadër të zbatimit të objektivit të politikës do të ndërmarrë masat e nevojshme, si:

- Ndryshimet në aktet nënligjore që preken nga ky projektligj.
- Informimin e grupeve të interesit të prekura nga ky ndryshim.
- Rritja e kapaciteteve profesionale të strukturave përgjegjëse.
- Monitorimin mbi zbatimin e politikës

Faza e monitorimit dhe vlerësimit

4. *Jepni një përshkrim të përmbledhur të masave të monitorimit dhe të vlerësimit.*
5. *Identifikoni kriteret/treguesit për të matur arritjen e objektivave ose progresin drejt tyre.*

Me qëllim monitorimin e zbatimit të opsionit të preferuar, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, nëpërmjet Agjencisë përgjegjëse për Eficencën e Energjisë duke përfshirë edhe institucionet e tjera monitoron zbatimin e politikës së re mbi eficienten energjetike mbi bazën e realizimit të objektivave Kombëtar të miratuar.

Zbatimi i Ligjit të Eficencës së Energjisë është një ndërmarrje shumë e rëndësishme për Shqipërinë, që kërkon vullnet politik të zbatuar në mënyrë konsekuente dhe kuptimplotë, koordinimin e të gjithë aktorëve të lidhur me energjinë brenda vendit dhe bashkëpunimin me partnerët shqiptarë të zhvillimit. Për më tepër, zbatimi i suksesshëm varet nga angazhimi i investitorëve privatë, donatorëve, kompanive publike të energjisë dhe burimeve të buxhetit të shtetit, si dhe nga menaxhimi me kosto efektive i këtyre burimeve brenda institucioneve shtetërore për të arritur rezultatet, produktet dhe impaktet e pritura. Zbatimi i suksesshëm i Ligjit të Eficencës së Energjisë varet nga qeverisja e mirë, përgjegjësitë e përcaktuara qartë, transparenca dhe pjesëmarrja e vazhdueshme e një game të gjerë institucionesh brenda qeverisë dhe jashtë saj.

Analizat e raportimit, monitorimit dhe vlerësimit janë thelbësore për një zbatim efektiv dhe në kohë të Ligjit të Eficencës së Energjisë dhe ky kapitull identifikon një sërë parametrash sasior të përcaktuara qartë për monitorimin e objektivave kryesore të këtij ligji. Këto parametra bazohen në objektivat strategjike dhe janë të nevojshme për të siguruar një bazë të qartë për monitorimin e progresit të Shqipërisë drejt zbatimit të Ligjit të Eficencës së Energjisë. Këto tregues të monitorimit renditen si më poshtë:

- Synimi/targeti i Eficencës së Energjisë (%); që llogaritet si raport i energjisë së kursyer në një vit të caktuar perkundrejt konsumit final të parashikuar në bazë të planit perkates të aprovuar të eficientes së energjisë;
- Reduktimi i humbjeve teknike të transmetimit të energjisë elektrike; që llogaritet si raport i humbjeve teknike në rrjetin transmetues perkundrejt energjisë elektrike që futen në rrjetin transmetues;
- Reduktimi i humbjeve teknike të shpërndarjes të energjisë elektrike; që llogaritet si raport i humbjeve teknike në rrjetin shpërndarës perkundrejt energjisë elektrike që futen në rrjetin shpërndarës; ;

Draft-Raporti i Vlerësimit të Ndikimit

- Vetëmjaftueshmëria e burimeve primare të energjisë kundrejt furnizimit total me burime primare të energjisë (%); që llogaritet si raport i shumës të gjithë burimeve primare të energjisë të prodhuara në vend kundrejt shumës së gjithë burimeve të energjisë të furnizuara në një vit të caktuar;
- Synimi/targeti i energjive të rinovueshme në TPES (Objektiva e BRE-se) (%); që llogaritet si raport i shumës së kontributeve të burimeve të rinovueshme të energjisë në një vit të caktuar kundrejt konsumit final të parashikuar në baze të planit përkatës të aprovuar të burimeve të rinovueshme të energjisë;
- Emetimi i CO₂ si reduktim përqindjeje I emetimeve GHG kundrejt totali të GHG të metuara sipas skenarit bazë (%); që llogaritet si raport i emetimeve të CO₂ dhe gazeve të tjera me efekt sere në një vit të caktuar kundrejt emetiveve përkatëse GHG të parashikuara në baze të dokumentit të NECP;

Ministria e Infrastruktës dhe Energjisë së bashku me ERE, AKBN dhe Agjencinë EE janë përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e të dhënave të nevojshme për të bërë llogaritjen vjetore të të gjithë parametrave të mesipër për të gjithë sektorët përkatës. Të gjithë institucionet që janë dhënë në listen përkatëse në tabelën 2 duhet të raportojnë në Ministri të Infrastruktës dhe Energjisë deri në 30 Prill të çdo viti rezultatet e vitit të mëparshëm në kuadër të unifikimit të raportimit dhe monitorimit të dokumentave strategjike. Ministria e Infrastruktës dhe Energjisë do të përgatise deri në 30 Qershor të çdo viti raportimin 1 vjeçar (dhe pasi të kalojnë 3 vite deri në 2020 – edhe raportin në kufij të shkurtër kohor) në lidhje me plotësimin e të gjithë tregësve të monitorimit. Raporti vjetor i Monitorimit të Zbatimit të Planit të Energjisë dhe Klimes si dhe synimeve të përcaktuara në Ligjin e Eficencës së Energjisë dërgohet për analizë në Këshillin e Ministrave.

Treguesit e monitorimit do të vlerësohen në mënyrë periodike nga Ministria e Infrastruktës dhe Energjisë së bashku me ERE, AKBN-në, Agjencinë EE. Raportet vjetore të monitorimit mbi zbatimin e Ligjit të Eficencës së Energjisë do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave për miratim. Informacioni do të mbledhet për treguesit përkatës të monitorimit në përputhje me llojin e ndërhyrjes. Të dhënat e monitorimit duhet të mbledhen çdo vit dhe disa nga këto të dhëna do të futen në Bilancin Vjetor të Energjisë, i cili përgatitet dhe përditësohet nga Ministria e Infrastruktës dhe Energjisë përmes INSTAT-it dhe AKBN-së. Të dhënat e mbledhura do të konfirmohen dhe transferohen në *EUROSTAT Energy Balance Template*, ku të dhënat do të përpunohen dhe sistemohen në tabelë me treguesit e monitorimit. Të gjithë treguesit e monitorimit do të jenë pjesë e raportit vjetor të monitorimit, i cili do të dorëzohet për vendimmarrje në Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë dhe pastaj do t'i dërgohen zyrtarisht Këshillit të Ministrave.

Tabela 2 paraqet një grupin e tregësve të monitorimit, të cilat përfshijnë vlerat e tyre bazë për periudhën 2025-2030. Raportet vjetore do të trajtojnë progresin në të gjithë sektorët dhe nënsektorët e energjisë, qoftë në aspektin e arritjeve të rëndësishme ose në aspektin e çështjeve të rëndësishme, siç janë ndërrimet kryesore të politikave, çështje serioze të zbatimit ose faktorë të tjerë. Raportet do të prodhohen në kohën e duhur, në mënyrë që institucionet qeveritare dhe partnerët e zhvillimit të mund të ndërmarrin veprimet e duhura. Prodhimi i raporteve vjetore mund të kombinohet me një konferencë ose tryezë të rrumbullakët vjetore të partneritetit për zhvillimin e qeverisë.

TABELA 2: Parametrat kryesor të monitorimit dhe institucionet përgjegjëse

Treguesit	Vlera bazë-2025	Qëllimet afatshkurtra 2026	Qëllimet afatmesme -2028	Qëllimet afatgjata 2030	Institucioni përgjegjës
Synimi/targeti i Efiçencës së Energjisë (%)	0.2%	2%	5%	8.4%	MIE/AEE

Reduktimi i humbjeve teknike të transmetimit të energjisë elektrike	2.20%	2.00%	1.80%	1.70%	MIE/ERE/OST
Reduktimi i humbjeve teknike të shpërndarjes të energjisë elektrike	14.00%	9.00%	7.00%	6.00%	MIE/ERE/ OSHEE
Hapja e tregut të energjisë elektrike	25%	40%	100%	100%	MIE/ERE
Vetëmjaftueshmëria e burimeve primare të energjisë kundrejt furnizimit total me burime primare të energjisë (%)	47.47%	50.37%	52.31%	55%	MIE/AKBN
Synimi/targeti i energjive të rinovueshme në TPES (Objektiva e BRE-se) (%)	40%	44.50%	49.0%	54.4%	MIE/AKBN
Emetimi i CO ₂ si reduktim përqindjeje i emetimeve GHG kundrejt totali të GHG të metuara sipas skenarit bazë (%)	2%	5.5%	11.50 %	18.7%	MTM/MIE/AKBN

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/aTabela: *Vlera aktuale neto në total (VAN) - kostot dhe përfitimet me vlerë monetare të përcaktuar në milionë lekë e zbritur për 10 vjet (Vlera aktuale e kostos dhe vlera aktuale e përfitimit); krahasuar me status quo-në (Opsioni 0 - status quo).*

	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Viti 6	Viti 7	Viti 8	Viti 9	Viti 10
Faktori zbritës	1.00	0.95	0.91	0.87	0.82	0.79	0.75	0.71	0.68	0.65
Kosto për buxhetin (institucionet qendrore dhe bashkiake) - një herë	450									
Kosto për Investimet per EE/RES per buxhetin (institucionet qendrore dhe bashkiake) - në vazhdimësi	729	884	1,071	1,299	1,574	1,908	2,312	2,802	3,396	4,116
Kosto për Energjine për buxhetin (institucionet qendrore dhe bashkiake) - në vazhdimësi	31,616	32,890	34,216	35,594	37,029	38,521	40,074	41,688	43,369	45,116
Kosto për bizneset - një herë	10,000									
Kosto për Investimet per EE/RES per bizneset - në vazhdimësi	7,116	8,101	9,223	10,501	11,955	13,611	15,496	17,642	20,085	22,867
Kosto për Energjine për bizneset - në vazhdimësi	195,900	199,760	203,695	207,708	211,800	215,972	220,227	224,565	228,989	233,500
Kosto për grupet e tjera (te gjitha familjet) - një herë	0									
Kosto për Investimet per EE/RES për grupet e tjera (te gjitha familjet) - në vazhdimësi	1,268	1,444	1,643	1,871	2,130	2,425	2,761	3,144	3,579	4,075
Kosto për Energjine për grupet e tjera (te gjitha familjet) - në vazhdimësi	53,360	56,884	60,641	64,647	68,917	73,469	78,321	83,494	89,009	94,888
Kosto në total	19,563	10,429	11,938	13,670	15,659	17,943	20,569	23,588	27,060	31,058

Draft-Raporti i Vlerësimit të Ndikimit

Kosto e zbritur = Kosto në total x Faktori zbritës	19,563	9,907	10,864	11,893	12,840	14,175	15,427	16,747	18,401	20,188
Përfitimet për buxhetin – një herë	0									
Përfitimet nga kursimet energjetike per buxhetin – në vazhdimësi	2,371	2,763	3,203	3,690	4,223	4,793	5,385	5,975	6,527	6,984
Përfitimet për biznesin – një herë	0									
Përfitimet nga kursimet energjetike per biznesin – në vazhdimësi	13,223	14,473	15,759	17,058	18,337	19,548	20,631	21,505	22,065	22,178
Përfitimet nga kursimet energjetike për grupet e tjera (te gjitha familjet) – një herë	0									
Përfitimet nga kursimet energjetike për grupet e tjera (te gjitha familjet) – në vazhdimësi	3,202	3,504	3,816	4,130	4,440	4,733	4,995	5,207	5,342	5,370
Përfitimet totale Përfitimi i zbritur = Përfitimi në total x faktori zbritës Vlera prezente aktuale e kostos në total	729	884	1,071	1,299	1,574	1,908	2,312	2,802	3,396	4,116
Vlera prezente aktuale e përfitimit në total	217,964									
Vlera prezente aktuale e kostos në total	191,477									
Vlera Prezente Neto Aktuale (VAN) = Vlera aktuale e përfitimit në total – Vlera aktuale e kostos në total	26,487									

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/a

Tabela: Vlera aktuale neto në total (VAN) - kostot dhe përfitimet me vlerë monetare të përcaktuar në milionë lekë e zbritur për 10 vjet (Vlera aktuale e kostos dhe vlera aktuale e përfitimit); krahasuar me status quo-në (Opsioni 1 -Ndryshimi i ligjit ekzistues 124/2015 per efijencën e energjisë).

	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Viti 6	Viti 7	Viti 8	Viti 9	Viti 10
Faktori zbritës	1.00	0.95	0.91	0.87	0.82	0.79	0.75	0.71	0.68	0.65
Kosto për buxhetin (institucionet qendrore dhe bashkiake) - një herë	563									
Kosto për Investimet per EE/RES per buxhetin (institucionet qendrore dhe bashkiake) - në vazhdimësi	656	829	1,046	1,321	1,668	2,106	2,658	3,356	4,237	5,349
Kosto për Energjinë për buxhetin (institucionet qendrore dhe bashkiake) - në vazhdimësi	31,616	32,890	34,216	35,594	37,029	38,521	40,074	41,688	43,369	45,116
Kosto për bizneset - një herë	15,000									
Kosto për Investimet per EE/RES per bizneset - në vazhdimësi	6,404	7,608	9,038	10,738	12,756	15,154	18,003	21,388	25,409	30,186
Kosto për Energjinë për bizneset - në vazhdimësi	195,900	199,760	203,695	207,708	211,800	215,972	220,227	224,565	228,989	233,500
Kosto për grupet e tjera (te gjitha familjet) - një herë	0									
	1,205	1,434	1,706	2,031	2,418	2,877	3,425	4,076	4,852	5,775
Kosto për grupet e tjera (te gjitha familjet) - në vazhdimësi	53,360	56,884	60,641	64,647	68,917	73,469	78,321	83,494	89,009	94,888
Kosto në total	23,828	9,870	11,791	14,090	16,841	20,137	24,086	28,821	34,498	41,310
Kosto e zbritur= Kosto në total x Faktori zbritës	23,828	9,377	10,730	12,258	13,810	15,908	18,065	20,463	23,459	26,852
Përfitimet për buxhetin – një herë	0									
Përfitimet nga kursimet energjetike për buxhetin – në vazhdimësi	2,371	2,878	3,475	4,171	4,972	5,878	6,879	7,951	9,047	10,084

Përfitimet për biznesin – një herë	0									
Përfitimet nga kursimet energjetike për biznesin – në vazhdimësi	13,223	15,102	17,159	19,382	21,740	24,183	26,633	28,968	31,015	32,530
Përfitimet për grupet e tjera (te gjitha familjet) – një herë	0									
Përfitimet nga kursimet energjetike për grupet e tjera (te gjitha familjet) – në vazhdimësi	3,202	3,663	4,170	4,719	5,304	5,911	6,522	7,107	7,624	8,011
Përfitimet totale	18,796	21,643	24,805	28,272	32,016	35,972	40,033	44,026	47,687	50,625
Përfitimi i zbritur = Përfitimi në total x faktori zbritës	18,796	20,561	22,572	24,597	26,253	28,418	30,025	31,259	32,427	32,907
Vlera prezente aktuale e përfitimit në total	267,814									
Vlera prezente aktuale e kostos në total	225,273									
Vlera Prezente Neto Aktuale (VAN) = Vlera aktuale e përfitimit në total – Vlera aktuale e kostos në total	42,541									

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/a

Tabela: Vlera aktuale neto në total (VAN) - kostot dhe përfitimet me vlerë monetare të përcaktuara në milionë lekë e zbritur për 10 vjet (Vlera aktuale e kostos dhe vlera aktuale e përfitimit); krahasuar me status quo-në (Opsioni 2 –Miratimi i nje ligji te ri).

	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Viti 6	Viti 7	Viti 8	Viti 9	Viti 10
Faktori zbritës	1.00	0.95	0.91	0.87	0.82	0.79	0.75	0.71	0.68	0.65
Kosto për buxhetin (institucionet qendrore dhe bashkiake) - një herë	1125									
Kosto për Investimet per EE/RES per buxhetin (institucionet qendrore dhe bashkiake) - në vazhdimësi	656	2,586	4,554	6,561	8,607	10,694	12,822	14,991	17,203	19,457
Kosto për Energjinë për buxhetin (institucionet qendrore dhe bashkiake) - në vazhdimësi	31,616	32,890	34,216	35,594	37,029	38,521	40,074	41,688	43,369	45,116
Kosto për bizneset - një herë	30,000									
Kosto për Investimet per EE/RES per bizneset - në vazhdimësi	6,404	26,839	46,865	66,488	85,714	104,548	122,997	141,067	158,763	176,091
Kosto për Energjinë për bizneset - në vazhdimësi	195,900	199,760	203,695	207,708	211,800	215,972	220,227	224,565	228,989	233,500
Kosto për grupet e tjera (te gjitha familjet) - një herë	0									
	1,205	5,797	10,710	15,959	21,563	27,539	33,907	40,688	47,901	55,570
Kosto për grupet e tjera (te gjitha familjet) - në vazhdimësi	53,360	56,884	60,641	64,647	68,917	73,469	78,321	83,494	89,009	94,888
Kosto në total	39,390	35,222	62,129	89,008	115,884	142,781	169,727	196,746	223,867	251,118
Kosto e zbritur= Kosto në total x Faktori zbritës	39,390	33,461	56,537	77,437	95,025	112,797	127,295	139,690	152,230	163,227
Përfitimet për buxhetin – një herë	0									
Përfitimet nga kursimet energjetike për buxhetin – në vazhdimësi	2,371	8,979	15,123	20,716	25,661	29,854	33,181	35,519	36,733	36,680

Përfitimet për biznesin – një herë	0									
Përfitimet nga kursimet energjetike për biznesin – në vazhdimësi	13,223	53,276	88,974	120,014	146,078	166,838	181,951	191,060	193,794	189,766
Përfitimet për grupet e tjera (te gjitha familjet) – një herë	0									
Përfitimet nga kursimet energjetike për grupet e tjera (te gjitha familjet) – në vazhdimësi	3,202	14,813	26,173	37,081	47,304	56,571	64,568	70,937	75,266	77,087
Përfitimet totale	18,796	77,068	130,270	177,811	219,044	253,263	279,700	297,515	305,793	303,532
Përfitimi i zbritur = Përfitimi në total x faktori zbritës	18,796	73,214	118,546	154,695	179,616	200,078	209,775	211,236	207,939	197,296
Vlera prezente aktuale e përfitimit në total	1,571,192									
Vlera prezente aktuale e kostos në total	1,325,872									
Vlera Prezente Neto Aktuale (VAN) = Vlera aktuale e përfitimit në total – Vlera aktuale e kostos në total	245,320									

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/a

Tabela: Vlera aktuale neto në total (VAN) - kostot dhe përfitimet me vlerë monetare të përcaktuar në milionë lekë e zbritur për 10 vjet (Vlera aktuale e kostos dhe vlera aktuale e përfitimit); krahasuar me status quo-në (Opsioni 3- jo rregullator).

	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Viti 6	Viti 7	Viti 8	Viti 9	Viti 10
Faktori zbritës	1.00	0.95	0.91	0.87	0.82	0.79	0.75	0.71	0.68	0.65
Kosto për buxhetin (institucionet qendrore dhe bashkiake) - një herë	1125									
Kosto për Investimet per EE/RES per buxhetin (institucionet qendrore dhe bashkiake) - në vazhdimësi	656	1,260	1,875	2,503	3,142	3,795	4,460	5,138	5,829	6,534
Kosto për Energjinë për buxhetin (institucionet qendrore dhe bashkiake) - në vazhdimësi	31,616	32,890	34,216	35,594	37,029	38,521	40,074	41,688	43,369	45,116
Kosto për bizneset - një herë	30,000									
Kosto për Investimet per EE/RES per bizneset - në vazhdimësi	6,404	12,750	18,969	25,062	31,032	36,879	42,607	48,216	53,709	59,087
Kosto për Energjinë për bizneset - në vazhdimësi	195,900	199,760	203,695	207,708	211,800	215,972	220,227	224,565	228,989	233,500
Kosto për grupet e tjera (te gjitha familjet) - një herë	0									
	1,205	2,680	4,258	5,943	7,740	9,657	11,697	13,869	16,179	18,633
Kosto për grupet e tjera (te gjitha familjet) - në vazhdimësi	53,360	56,884	60,641	64,647	68,917	73,469	78,321	83,494	89,009	94,888
Kosto në total	39,390	16,691	25,102	33,508	41,915	50,331	58,764	67,223	75,717	84,253
Kosto e zbritur= Kosto në total x Faktori zbritës	39,390	15,856	22,843	29,152	34,370	39,761	44,073	47,728	51,487	54,765
Përfitimet për buxhetin – një herë	0									
Përfitimet nga kursimet energjetike për buxhetin – në vazhdimësi	2,371	4,374	6,227	7,902	9,368	10,593	11,541	12,173	12,447	12,317

Përfitimet për biznesin – një herë	0									
Përfitimet nga kursimet energjetike për biznesin – në vazhdimësi	13,223	25,310	36,013	45,239	52,886	58,852	63,029	65,304	65,560	63,676
Përfitimet për grupet e tjera (te gjitha familjet) – një herë	0									
Përfitimet nga kursimet energjetike për grupet e tjera (te gjitha familjet) – në vazhdimësi	3,202	6,849	10,406	13,809	16,981	19,837	22,275	24,180	25,421	25,848
Përfitimet totale	18,796	36,533	52,647	66,949	79,236	89,282	96,845	101,657	103,427	101,840
Përfitimi i zbritur = Përfitimi në total x faktori zbritës	18,796	34,706	47,908	58,246	64,973	70,533	72,633	72,176	70,331	66,196
Vlera prezente aktuale e përfitimit në total	576,499									
Vlera prezente aktuale e kostos në total	492,893									
Vlera Prezente Neto Aktuale (VAN) = Vlera aktuale e përfitimit në total – Vlera aktuale e kostos në total	83,606									

RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT - SHTOJCA 2/B

Tabelë: Permbledhje e Vlerave aktuale neto (në milion ALL) në total për çdo opsion të analizuar

Opsioni	Kosto	Vlera aktuale në milionë lekë		Vlera aktuale neto në milionë lekë
		Kosto	Përfitimi	
Opsioni 0 - status quo	Pagat e punonjesve të MIE hartojnë politikat dhe pagat e punonjesve të AEE për implementimin e tyre	191,477	217,964	26,487
Opsioni 1 - Ndryshimi i ligjit ekzistues 124/2015 për efikasitetin e energjisë	Pagat e punonjesve të MIE hartojnë politikat dhe pagat e punonjesve të AEE për implementimin e tyre	225,273	267,814	42,541
Opsioni 2 – Miratimi i një ligji të ri	Pagat e punonjesve të MIE hartojnë politikat dhe pagat e punonjesve të AEE për implementimin e tyre.	1,325,872	1,571,192	245,320
Opsioni 3- jo rregullator	Pagat e punonjesve të MIE hartojnë politikat dhe pagat e punonjesve të AEE për implementimin e tyre	492,893	576,499	83,606

MINISTËR

ENEA KARAKAÇI



Publisher

Partnership for Energy Efficiency in Buildings (PEEB) Secretariat
c/o Agence Française de Développement (AFD)
5 Rue Roland-Barthes
75012 Paris, France
E info@peeb.build
I www.peeb.build

The Partnership for Energy Efficiency in Buildings (PEEB) is currently funded by the German Federal Ministry for Economic Affairs and Climate Action (BMWK), the French Ministry of Ecological Transition and Territorial Cohesion (MTECT), the Green Climate Fund (GCF), the European Union (EU), the Agence Française de Développement (AFD), the International Climate Initiative (IKI), and the Fonds Français pour l'Environnement Mondial (FFEM). The Partnership is part of the Global Alliance for Buildings and Construction (GlobalABC).

PEEB is implemented by the Agence Française de Développement (AFD), the Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, and the French Agency for Ecological Transition (ADEME).

Author

Besim Islami, Local Expert

Reviewer

Lena Lampropoulou, Key Expert on Building policies

Responsible/Editor

Secretariat of the Partnership for Energy Efficiency in Buildings (PEEB)

Image Credits

© Cover: Vincent Camacho on Unsplash

Published

[Insert date (e.g. October 2024)]

Funded by

